

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**

**Drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe**



# **PUNIM I MAGJISTRATURËS**

**Tema:**

**KADAREJA DHE VEPRAT: “PALLATI I ËNDRRAVE”  
DHE “DIMRI I VETMISË SË MADHE” – ANALIZA, KRAHASIME  
DHE INTERPRETIME**

**Kandidati:**

**Fitore Jerliu**

**Mentori:**

**Prof. Dr. Zeqir Kadriu**

**Tetovë, 2019**

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”  
– analiza, krahasime dhe interpretime”*

**Përmbajtja:**

Deklarata dhe falënderimet.....	3
Abstrakti.....	4
1. HYRJE .....	6
1.1. Struktura e ndërtimit .....	10
1.2. Bota narrative e rrëfimit.....	16
1.3. Botëkuptimet e karaktereve.....	22
1.4. Bota imagjinare e rrëfimit.....	28
1.5. Kultura e shkrimit.....	31
1.6. Realiteti dhe alegoria.....	34
1.7. Lexime dhe interpretime.....	38
1.8. Dialogu dhe monologu narrativ.....	41
2. QËLLIMI I HULUMTIMIT.....	48
3. METODAT E STUDIMIT.....	50
4. REZULTATET.....	51
5. BIOGRAFIA.....	59
7. PËRFUNDIMI.....	66
8. LITERATURA .....	71

**Fjala kyçe:** *Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe” – analiza, krahasime dhe interpretime”*

## **Deklarata dhe falënderimet**

Të gjitha pjesët të cilat janë marrë nga tekstet e caktuara, janë të shënuara me referencë. Gjithashtu, me plot përgjegjësi deklarojmë se punimin në fjalë nuk e kemi dorëzuar kund tjetër, pos te mentori dhe komisioni i caktuar.

Nëpërmjet kësaj deklarate pohojmë se punimin e temës së magjistraturës me titull: " Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe” – analiza, krahasime dhe interpretime”, e kemi mbaruar sipas rregullave të parapara me statut të Universitetit të Evropës Juglindore të Tetovës, Drejtimi: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe.

Kemi kënaqësinë, gjithashtu, të shprehim mirënjohjen më të thellë për personat, që kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë gjithë kohës sa kemi punuar në këtë temë diplome.

Mentorit, Prof. Dr. Zeqir Kadriu, i takon falënderimi më i veçantë për ndihmën, koordinimin dhe udhëheqjen profesionale gjatë punës së këtij punimi.

Falënderojmë, po ashtu, të gjithë kolegët me të cilët jemi konsultuar rreth projektit të këtij punimi të magjistraturë e posaçërisht drejtorët, personelin e bibliotekave.

Duke i falënderuar të gjithë ata, që në çfarë do mënyre kontribuan në realizimin e kësaj teme, mbesim me shpresë që ky punim, t’i hyjë në punë, atyre që merren me studime në fusha të ndryshme të kulturës e posaçërisht në fushën e prozës së kolosit të madh të letrave shqipe Ismail Kadareja.

Faleminderit!

Me respekt:

**Fitore Jerliu**

## **Abstrakti**

Në këtë punim magjistrature jam përpjekur t’i analizojmë veçoritë letrare dhe artistike të veprave madhore të shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, duke shqyrtuar botëkuptimet e karaktereve mes tyre, në saje të vështrimeve analitike, hulumtimeve dhe interpretimeve.

Gjatë këtij punimi, gjithashtu, kemi shfrytëzuar metodën analitiko-teorike e krahasimtare, të botëkuptimeve të karaktereve, gjithnjë duke marrë parasysh botëkuptimet e autorit që shprehë përmes personazheve, mendimeve dhe botëkuptimeve në veprat e tij letrare.

Në këtë drejtim, përgjatë këtij punimi, kemi nxjerr edhe një përfundim rreth botëkuptimeve, që karakterizojnë veprat në fjalë, duke aluduar në ngjarjet që zhvillohen brenda tekstit, konstruktet brenda dialogut, bota e rrëfimit dhe në pikëpamjet estetike të autorit.

Nga njëra anë punimi na ka njohur me përsiatjet e autorit rreth “Pallatit të ëndrrave”, një udhëtim i jashtëzakonshëm, tmerrësisht mahnitës, dhe poetikisht marramendës, një labirint i skëterrshëm i pushtetit e i shpirtrave, ku autori na e shënon rrugën me saktësinë e rrëfimit të tij përmes të papriturash të panumërta gjer në dalje.<sup>1</sup>

Romani “*Pallati i Ëndrrave*” shënon një hap të rëndësishëm në krijimtarinë artistike të Kadaresë. Në këtë roman, duke trajtuar një temë historike, autori flet për Shqipërinë staliniste dhe utopitë që krijoi ajo ideologji. Ndonëse ngjarja është e zhvendosur në periudhën osmane, qëllimet e autorit duken të qarta: ai ngre kambanën e alarmit nga rreziku i ëndrrave utopike.

Kritiku amerikan Richard Eder këtë roman të Kadaresë e cilëson si nga më të mirët e autorit dhe shkruan: “*Pallati i Ëndrrave, një fantazi për burokracinë e madhe otomane që mbledh ëndrrat e njerëzve dhe ia raporton më të rrezikshmet Sulltanit. Është kjo një parabolë e përshëndetë mbi marrëzitë e pushtetit - vrasës e vetëvrasës në të njëjtën kohë.*”

***Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”***

***– analiza, krahasime dhe interpretime”***

*Por, romani është zbavitës po ashtu, dhe të pushton me tonin e pafajësisë. Këto janë dy cilësi të rregullta, bashkë me tmerrin, në romanet e Kadaresë.”<sup>2</sup>*

Arkitekti i këtij pallati të errët ka vlerën e një tabele treguese letrare për Shqipërinë e Kadaresë, një artist që shfaqet në dy role: herë ushtar cinik i partisë, herë kritik i regjimit. Historia e "Pallatit të Ëndrrave" lindi nga fundi i viteve shtatëdhjetë; Shqipëria po përjetonte pothuajse një valë të gjerë represioni. Pikërisht për këtë arsye, Kadare i ngre një vello historike tekstit të tij.

Në anën tjetër, bota e rrëfimit të romani “Dimri i vetmisë së madhe”, shpalos mendimet dhe botëkuptimet e autorit, lidhur me dimrin e ashpër alegorik, i cili pamëshirshëm e kishte mbërthyer Shqipërinë e dikurshme komuniste dhe izolimin e saj, pas prishjes së marrëdhënieve shqiptaro-sovjetike. Shturja e raporteve me ish aleatët komunistë jugosllavë e sovjetikë, Shqipërisë së romanit “Dimri i vetmisë së madhe”, i kishte mbetur vetëm bashkëpunimi me Kinën e largët.

Stili i bisedimit politik dhe emocional në “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, duke tërhequr një paralele midis tyre, paraqet një kontribut në hartimin e kësaj teme të magjistraturës.

Duke zgjedhur si objekt të punimit Kadarenë dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe” – analiza, krahasime dhe interpretime”, kemi sjell në mënyrë të detajuar veçoritë karakteristike të prozës artistike, të këtij zhanri letrar, i cili nëpër periudha të ndryshme ka qenë dhe mbetet burim frymëzimi për shumë kritikë dhe studiues të letërsisë.

---

<sup>1</sup> Shehu, Bashkim, Përsiatje rreth “Pallatit të ëndrrave”, Kadare, leximi dhe Interpretimi, ese dhe studime, Onufri, Tiranë, 2016, fq.5

<sup>2</sup> Eder, Richard, “Pallati i ëndrrave”, Kadare - ndëshkimi, tmerrin, The New York Times, 2002., fq. 184

## **1. HYRJJE**

Gjatë punimit të kësaj teme, jemi përpjekur të paraqesim rolin dhe rëndësinë që kanë prozat e Ismaili Kadaresë, posaçërisht romanet: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, janë pritur mirë nga publiku dhe kritika letrare.

Njëkohësisht, duke u fokusuar në prozat artistike të Kadaresë, nxjerrim në pah tezën se këto romane, janë të mbështetura në rrëfime interesante, me vlerat mahnitëse dhe njëherit burim i pashtershëm frymëzimi për shumë krijues të ndryshëm.

Gjithashtu, në kuadër të këtij punimi të magjistraturës, jemi përpjekur të tërheqim një paralele midis stilit të shkruar e të shprehur të autorit të madh të letrave shqipe Ismail Kadare, i cili me botimin e romaneve: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, në periudhën prej viteve 1971-1981, me të cilat ka paraqitur një nga krijimet kulmore të tij, për të cilat letërsia evropiane, jo rrallë e vendoste autorin e tyre në listën e kandidatëve për çmimin “Nobel”, që nuk arriti ta gëzojë deri tani.

Po ashtu, si qëllim i punimit ishte hulumtimi se çka e motivoi Kadarenë, të bëjë një rrugëtim dhjetë vjeçar nga “Pallati i ëndrrave” deri te “Dimri i vetmisë së madhe”, të nxjerr në sipërfaqe botëkuptimit, që i karakterizojnë veprat në fjalë, duke aluduar në ngjarjet që zhvillohen brenda tekstit, konstruktet brenda dialogut, bota e rrëfimit dhe në pikëpamjet estetike të autorit.

Në kuadër të këtij punimi do të nxirret në spikamë gjuha e ashpër alegorike e autorit, të shkruar gjatë kohës së diktaturës, ferrit të kuq komunistë, që tjetërsonte individin dhe shkatërronte konceptin e qytetarisë kolektive.

Gjatë analizës së këtyre dy romaneve, që është objekt i studimit të këtij punimi, kemi hasur në një kontekst të qartë të tipareve më të spikatura narrative, mbizotëruese në korpusin e madh kadarean. Ndërmarrja e kësaj teme, e mbi të gjitha për shkrimtarin më të

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

madh shqiptar, ka qenë një sfidë jo e lehtë, e kjo duket konceptuar në dy këndvështrime: Së pari, në pasurinë e pashtershme që paraqet vepra e shkrimtarit Ismail Kadare, në të gjithë përbërësit e saj, në tekst e në kontekst. Së dyti, në shumanshmërinë e aspekteve narrative që parashtron vepra kadareane.

Gjithsesi, gjatë shtjellimit të kësaj teme më kanë ndihmuar: Metoda deskriptive, e cila është një metodë që të ndihmon në fazat fillestare të punës kërkimore. Në këtë punim, metoda deskriptive më ka shërbyer si një qasje e thjeshtë e përshkrimit të narracionit në prozën letrare të Kadaresë, duke u njohur e duke përshkruar karakteristikat kryesore.

Hulumtimi përshkruar zakonisht i paraprin hulumtimit shpjegues. Shpesh qasja më e mirë, para se të ndërmerret një hulumtim, është për të kryer një hetim e hulumtim kualitativ, për të bërë gjetjet e duhura, në mënyrë që të arrihet një punim sa më autentik.

Duke u bazuar në këtë metodë, janë analizuar lidhjet e raporteve të ndryshme të rrëfimit, të narratorit, të autorit dhe të personazheve, lidhjet e narratorit të brendshëm me atë të jashtëm etj. Përshkrimi i dukurive që hulumtohen dhe trajtohen në të gjithë krerët e punimit, është i detajuar, i interpretuar, i analizuar dhe i shoqëruar me shembuj konkretë nga veprat përkatëse.

Metoda komparative (e krahasimit) është një metodë, e cila më ka shërbyer dhe ndihmuar njëkohësisht për të peshuar elementet krahasuese, veçoritë e përbashkëta dhe dallimet mes tyre, në dy këndvështrime: në identifikimin e veçorive të përbashkëta narrative dhe në krahasimin e tyre. Në këtë punim nuk është shfrytëzuar thjesht krahasimi normativ, por është bërë një krahasim përshkruar, duke mundësuar shpjegimin e invariancës: tekstin e mëparshëm - ngjarjet e mëparshme dhe tekstin e mëvonshëm – zbërthimin e ngjarjeve, lidhur me shpjegimin kontekstual.

Krahasimi është një nga metodat më efikase për të shfrytëzuar njohuritë ose edhe për të mbajtur qëndrime të caktuara gjatë analizës. Metoda e klasifikimit është e pranishme në

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

kuptimin gjithëpërfshirës. Klasifikimi është ndarje sistematike dhe e plotë e kuptimeve të plota në kuptime të veçanta, është një metodë, e cila fikson ndarjen e veprave ose të kuptimeve, duke i vendosur në rend dhe rregull të dhënat e përziera. Kjo metodë është zbatuar kryesisht në shtojcat e këtij punimi. Në këtë punim, kjo metodë zbatohet me qëllim të trajtimit, të artikullimit të analizës dhe të sintezës, duke mundësuar një njohje tërësore me krijimtarinë e shkrimtarit Ismail Kadare.

Mund të themi me bindje të thellë se rëndësia e këtij punimi është se kemi të bëjmë me dy vepra madhore të letrave shqipe, që kanë për autor një nga personalitetet më të shquara të kulturës shqiptare dhe evropiane Ismail Kadare, të cilin lexuesit dhe kritika letrare e njohin si njërin nga krijuesit më të mëdhenj botëror.

“Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, janë vepra thelbësore të Kadaresë, njërat nga më të përfolurat dhe më të analizuarat nëpër periudha të ndryshme kohore, duke nxjerr në opinion botën e pasur letrare, artistike e narrative, me një stil të lartë shkrimor dhe me një kulturë të pasur gjuhësore e ideore.

Jehona e artit të tij letrar ka kapërcyer kufijtë e letërsisë shqipe duke krijuar ura lidhëse dhe duke u integruar me sukses në letërsinë evropiane dhe atë botërore. “Pallati i ëndrrave”, mes të tjerash, konsiderohet si një nga romanet më të bukura dhe më të guximshme të Ismail Kadaresë. Një sërë kritikësh lejimin e botimit të kësaj vepre gjatë qeverisjes komuniste e kanë parë si mrekulli më vete, duke pasur parasysh shtresimet alegorike që përmban ajo.

Romani “Pallati i ëndrrave” shënon një kapërcim të rëndësishëm në krijimtarinë artistike të Kadaresë. Në këtë roman, shëmbëllyeshëm me letërsinë e Kafkës, Kadare ndërton absurdin letrar si simbolizëm shumëdimensional, duke trajtuar një temë historike, por ku nënteksti flet për Shqipërinë staliniste dhe utopitë që krijoi ajo ideologji. Ndonëse ngjarja është e zhvendosur në periudhën osmane, qëllimet e autorit duken të qarta: ai ngre kamberën e alarmit nga rreziku i ëndrrave utopike. Nën këtë interpretim, përshkrimi që i



*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

bëhet Pallatit të ëndrrave në roman, përdorimi i njësive verbale, shprehjet gjuhësore, ngjyrimet emocionale dhe reagimi ndaj qenësisë së tij përdoret me po atë intensitet emocionesh e vlerash. ((Fragment nga një studim i botuar në librin “Kadare, leximi dhe interpretimi”)<sup>3</sup>

Diktatura shqiptare ka qenë nga më të egrat për sa i përket diktatit mbi artet. Megjithatë me “Dimrin e Vetmisë së Madhe”, Kadare ka bërë një nga sfidat më të vështira që një shkrimtar i ish vendeve komuniste mund të ketë bërë, është përballur hapur ne një libër me tiranin e tij.

Në këtë libër Enver Hoxha është një personazh, ndoshta ky është dhe fakti që shkrimtari i shpëtoi pasojave, duke pasur parasysh pasionin e diktatorit për shkrimin. Ky ishte një rast që ai të bëhej i njohur në të gjithë botën, pasi në ato vite Kadare kishte nisur të përkthehej në Francë”, thotë Alda Bardhyli.<sup>4</sup>

Ky punim do ta ketë rëndësinë e hartimit, për vet faktin se ka të bëjë me dy romane nga më të rëndësishme të autorit Kadare, Kadare njihet si shkrimtar i cili në veprat e tij në mënyrë të qëllimshme u shmang nga realizmi socialist, dhe si i tillë veprat e tij u përkthyen dhe u lavdëruan nga kritikët dhe lexuesit anembanë botës. Ai krijoi një vepër me karakter universal por që rrënjët i ka thellë në tokën shqiptare.

Kadare konsiderohet nga disa si një nga shkrimtarët dhe intelektualët më të shquar evropianë të shekullit të 20-të, si dhe një zë universal kundër totalitarizmit.

---

<sup>3</sup> Hamiti, Sabri, Tematologjia, ASHAK, Prishtinë 2005, f. 123

<sup>4</sup> Bardhyli, Alda, Kadare dhe disidenca te “Dimri i vetmisë së madhe”, Gazetaexpresse diel, 05 Tetor 2014, fq.7.

<sup>5</sup> Marrë nga Wikipedia

## **1.1. Struktura e ndërtimit**

Romani “Pallati i Ëndrrave” përfaqëson intuitën krijuese, universin imagjinar ndoshta më të larmishëm në krijimtarinë e shkrimtarit Ismail Kadare. Këto krijime autentike, e përfytyrime njëkohësisht, nuk përfaqësojnë vetëm krijime të kategorive leksikore, por edhe krijime të kategorive konceptuale (ideore, kuptimore), duke filluar që nga institucioni i Tabir Sarajit (Pallatit të Ëndrrave), ëndërrparësve, ëndërrçuesve, bashëndrës/kryeëndrës etj., e duke vazhduar tek endja e ëndrrave dhe sistemi simbolik që i shoqëron e i zbërthen ato.

I gjithë ky shtet vjen si referencë e së shkuarës përmes së tashmes. Edhe romanet distopike zakonisht përshkruajnë jetën në një vend imagjinar, ku çdo gjë është tërësisht e keqe, shqetësuese, individët ndihen gjithmonë të paqetë, ‘nuk i zë vendi vend’. “Pallati i Ëndrrave” është pjesë e një universi imagjinar kadarean, si pjesë e fiction-it dhe, gjithashtu, shembulli më i qartë për të treguar kontrollin që ndodh në një shoqëri distopike, nën trysninë e një qeverie totalitare, të drejtuar nga diktatura e sistemit komunist.

Tabir Saraji (Pallati i Ëndrrave) është krijim autentik i shkrimtarit Ismail Kadare, jo vetëm si krijim gjuhësor (si kategori leksikore): sintagmë emërore turko-arabe pranëvënë asaj në gjuhën shqipe, por edhe si krijim ideor: nuk ekziston asnjë institucion, së paku, që të merret me grumbullimin, seleksionimin dhe interpretimin e ëndrrave të shtetasve; hiperbolë – zmadhimi i dukurisë së mbikëqyrjes së ëndrrave mbi të gjithë shtetasit, për të theksuar idenë e mbikëqyrjes totale dhe përndjekjes së shtetasve – të gjithë janë të rrezikuar prej ëndrrave që mund të shohin, të gjithë ndiejnë frikë të shohin ëndrra.

Sipas kritikëve shqiptarë e të huaj 135 , Pallati i Ëndrrave është një aluzion për Komitetin Qendror të Shqipërisë komuniste. Do të shtonim se për sa i përket funksionit, institucioni i Pallatit të Ëndrrave mbetet një krijim mirëfilli autentik, siç theksuam edhe më lart, një univers imagjinar kadarean, ndërsa për sa i përket strukturës, hierarkisë, pozicionimit

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

gjeografik dhe, sidomos kur përshkruhet si ngrehinë arkitekturore mund të përngjasojë me institucionin e Komitetit Qendror të PPSH-së, gjithashtu, edhe duke e krahasuar me rolin suprem që ai zotëronte si organi më i lartë i PPSH-së, ashtu sikurse ishte edhe “Pallati i Ëndrrave” – institucioni më i rëndësishëm i shtetit perandorak, i krijuar me interesimin e drejtpërdrejtë të sulltanit sovran.

“Pallati i Ëndrrave” përfaqëson institucionin më të rëndësishëm të shtetit perandorak, më të vjetrin e, sipas mendimit të njërit prej personazheve, Kurtit, pavarësisht emrit të bukur që ka, ai është institucioni më i tmerrshëm... midis gjithë mekanizmave të shtetit, Pallati i Ëndrrave është ai që qëndron më jashtë vullneteve njerëzore se të gjithë të tjerët... Ai është më impersonali i të gjithëve, më i verbri, më fatali, pra edhe më shtetërori... institucioni më absurd i perandorisë...

– Do të ishte absurd në një botë logjike, - tha Kurti. - Kurse në botën tonë mua më duket më se normal. Këto përfaqësojnë disa prej sentencave më të fuqishme e më eksplicite të novelës Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave, ku nëpërmjet këtij institucioni, pjesa më e errët e ndërgjegjes së të gjithë shtetasve krijon kontakt të drejtpërdrejtë me shtetin.

Madje prej narratorit, “Pallati i Ëndrrave” konsiderohet si një kafaz tigrash që mbante një emër joshës, por që në të vërtetë s’ishte gjë tjetër veçse një mekanizëm i verbër fatal dhe mizor. Puna në këtë institucion misterioz krahasohej si një punë skëterre. Institucioni misterioz i “Pallatit të Ëndrrave” shtie në dorë ëndrrat e të gjithë shtetasve, pa përjashtim, gjithashtu, është vendi ku monitorohen, hetohen dhe gjykohen ëndërrparësit e bashëndrës/kryeëndrës.

Ëndrra dhe ankthet përbëjnë botën e vetëdijes në këtë roman, kështu ëndërrparësit janë të vetëdijshëm se ëndrra për ta mund të jetë akt shpëtimi – ngritje në detyrë, shpëtimi i shtetit prej sulmeve nëpërmjet sinjaleve që kanë paralajmëruar ata me anë të ëndrës së tyre; ose akt ndëshkimi – viktima të këtij mekanizmi burokratik, përmes përndjekjes, dënimit e madje edhe ekzekutimit. Ata nuk e dinë si mund të interpretohet ajo, prandaj

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

janë të detyruar të jenë sa më transparentë, sepse mbikëqyrja është në një shkallë aq të lartë sa depërton deri në të padepërtueshmen, në ëndërr.

Institucionet qeveritare, të përfaqësuara në këtë rast me më kryesorin, Tabir Sarajin (Pallatin e Ëndrrave), përdorin, madje mbikëqyrin një formë manipuluese të nënvetëdijes, ëndrrën. “Pallati i Ëndrrave” monitoron shtetasit e vet në çdo çast të ditës e të natës, madje edhe gjendjen e gjumit/ëndrrën.

Rreziku që u kanoset qytetarëve nuk mund të imagjinohet as prej tyre e as prej zyrtarëve të këtij institucioni të trishtë. Koncepti i lirisë, në të gjithë kuptimet e tij, duket se mungon gjithkund. Por, nga ana tjetër, grotesku i lirisë është se fizikisht individët e këtij vendi janë të lirë, përveçse në rastet kur ata dënohen kryesisht për shkak të ëndrrës që mund të kenë parë. Ata “nuk” janë të izoluar nga bota e jashtme, vetëm nënvetëdija e tyre mbahet nën vëzhgim.

Njerëzit trajtohen si kavie, ëndrrat e tyre vendosen në laborator dhe ata janë aq të nënshtruar sa presin me frikë vendimin që do të merret për ta, jo nga ajo që kanë vepruar me vetëdije të plotë, sepse kjo nuk mund të imagjinohet që të ndodhë, por për atë çka mund të zbulohet nga e nënvetëdijshmja që mund t’u jetë shfaqur në ëndërr. Individët e këtij shteti totalitar janë të bindur e të nënshtruar dhe presin të frustruar vendimin për veten e tyre.

Një shoqëri e tillë nuk ka të ardhme, mbetet peng e së tashmes dhe e së shkuarës. Individët janë të kushtëzuar, të mjerë, të mbikëqyrur në vetëdije e nënvetëdije, dhe janë “të gatshëm” për të pranuar çfarëdo shteti ushtron e vendos për ta. Në këtë roman pasqyrohen shqetësimet në rritje të sistemit komunist. Njerëzit shfaqen të tjetërsuar, individualiteti dhe të drejtat e njeriut janë kufizuara nga qeveria. Tek ata mbizotëron frika, terrori, aq sa nuk mund të shohin dot as ëndrra, sepse edhe ëndrrat “monitorohen”.

***Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”***

***– analiza, krahasime dhe interpretime”***

Përpunimi i ëndrrave në Pallat është një proces filtrues, karakteristik për institucionet totalitare, dhe kalon në disa sektorë (faza). Rëndësia dhe përgjegjshmëria në të cilët rritej nga sektori në sektor. Në këta sektorë punojnë njerëz tepër të besueshëm e të përkushtuar ndaj shtetit, persona që duhet medoemos të ruajnë sekretin e institucionit.

***Sektorët e përpunimit të ëndrrave në roman janë:***

***- kopisteria, grumbullimi /mbledhja e ëndrrave,  
përzgjedhja/seleksionimi, klasifikimi/përndarja,  
interpretimi, kryeëndrra-bashëndrra.<sup>6</sup>***

Në të vërtetë, këta sektorë nuk lidhen drejtpërdrejt me përpunimin e ëndrrave, por me proceset e mbikëqyrjes/survejimit total/e të shtetit ndaj shtetasve të vet, me hetimin, me vëzhgimin e me përndjekjen në bashkëkohësinë komuniste të autorit, në kohën kur u shkrua vepra. Edhe “Pallati i Ëndrrave”, institucioni në të cilin mblidhen ëndrrat, përbën pallatin e tmerrit, hetimit, dhunimit e ndëshkimit të lirisë individuale – cilësuar prej narratorit si institucion hijerëndë.

Detyra themelore e këtij institucioni është: me anë të kumtit që përcjell ëndrra, paralajmërimi që ajo lëshon, të parandalojë fatkeqësinë e shtetit të sovranit, prandaj Pallati i Ëndrrave është një nga themelet e shtetit ‘perandorak’. Sektori më i rëndësishëm i tij është interpretimi, sepse gjithçka fillon nga ky proces, i cili merret me interpretimin politik të ëndrrave. Sa më me karakter kundërpushtetar të jetë një ëndërr aq më kryeëndërr bëhet. Karriera e vërtetë e “Pallatit të Ëndrrave” fillon nga sektori i interpretimit: Interpretimi është fshehtësi mbi fshehtësinë<sup>7</sup>.

---

<sup>6</sup> Kryeziu, Jorina, Narratori dhe narracioni në prozën e Ismail Kadarese, Tiranë, 2015, fq. 130.

<sup>7</sup> Kadare, Ismail, (1999), Pallati i Ëndrrave, Tiranë, Onufri, f. 126

*Kadareja dhe veprat: "Pallati i ëndrrave" dhe "Dimri i vetmisë së madhe"*

*– analiza, krahasime dhe interpretime*

Një nga kërkesat themelore të "Pallatit të Ëndrrave" është fshehtësia e plotë: Përveç Tabirit të zakonshëm është edhe Tabiri i Fshehtë, që merret me përpunimin e ëndrrave që njerëzit nuk i bien vetë në pallat, por që shteti me anë të mjeteve dhe mënyrave të tij, i shtie në dorë.

Mënyra e organizimit të punës në "Pallatin e Ëndrrave" ka disa kërkesa kryesore: përveç punës së madhe (këtu nënkuptohet puna e madhe e PPSH-së), ka një rëndësi të madhe mbyllja e plotë e Tabir Sarajit ndaj çdo ndikimi të jashtëm (këtu nënkuptohet armiqësia që ka pasur sistemi totalitar ndaj kapitalizmit, perëndimit – ndikimeve të huaja), shumë njerëz dhe shumë rryma kanë dashur të depërtojnë këtu, por Tabir Saraji nuk ka rënë kurrë në grackë (bëhet fjalë për njerëzit që nuk janë pajtuar me diktaturën dhe janë përpjekur të dalin kundër, tjetërmendësit, disidentët).

Dimri i ashpër i viteve '60-'61, ishte me rëndësi në historinë shqiptare të pasluftës. Ai vit shënoi prishjen midis Nikita Hrushovit dhe Enver Hoxhës dhe dëshmoi tërheqjen e Shqipërisë nga blloku Lindor. Hoxha, pas disa manovrimesh tinzake në një luftë të brendshme për pushtet në vitet pesëdhjetë, e pati lidhur fatin e popullit të vet me Bashkimin Sovjetik dhe Traktatin e Varshavës për t'iu kundërvënë ndikimit kërcënues të Titos mbi këtë vend të vogël të Ballkanit.

Shqipëria nuk ishte parathënë të bëhej republikë e federatës jugosllave, dhe Bashkimi Sovjetik ishte gati që të luante për atë një deus ex machina. Por në botën komuniste filluan të fryjnë erërat e ndryshimeve. Kur Hrushovi, më 1960, ndërpreu furnizimet me drithë për të treguar pakënaqësinë e tij për aleancën shqiptarokineze, Hoxha iu kundërvu kryelartë: "Edhe bar do hamë, por nuk gjunjëzohemi".

Poshtërimi për shqiptarët krenarë, por të varfër u bë sidomos i dukshëm me atë thënie, tani të njohur, që Hrushovi kishte lëshuar më parë gjatë një vizite në Shqipëri se aq drithë sa prodhonte Shqipëria e hanin minjtë nëpër depot e Bashkimit Sovjetik. Shqiptarëve iu desh përsëri të mbroheshin, kësaj radhe duke e ditur fort mirë se nuk kishin aleatë të tjerë

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

të drejtpërdrejtë përveç kinezëve të largët. Situata e nderë arriti kulmin kur Enver Hoxha e akuzoi haptazi Bashkimin Sovjetik se po bënte politikë kolonialiste.

Dimri i madh pasqyron këto ngjarje emocionante në dy rrafshje: në atë politik e në atë personal, që nga tryeza e bisedimeve në Kremlin e deri te shtëpitë e njerëzve të thjeshtë në Tiranë. Personazhi kryesor i romanit është Besnik Struga, një gazetar nga Tirana, që caktohet si përkthyes në përbërjen e delegacionit shqiptar dhe niset për në Moskë në një kohë kur nëpër vendet e Evropës Lindore po zbresin dëborërat e para të dimrit të madh. Atje ai merr pjesë në bisedimet, pritjet dhe bisedat e fshehta në nivel të lartë, duke përjetuar e dëshmuar drejtpërdrejt intrigat politike.

Me mjeshtri Kadareja ka rindërtuar mjaft nga dialogu i zhvilluar, dhe këtë e ka bërë pasi ka shfletuar protokollat e bisedimeve dhe kujtimet e Enver Hoxhës, duke na hapur kështu një dritare unike për të parë disi mekanizmin e botës komuniste të asaj periudhe. Besniku është aq shumë i tronditur nga ditët e tij në Moskë sa që marrëdhëniet e tij me Zanën, të fejuarën që e pret në Tiranë, nuk mund të vazhdojnë më dhe ndërpriten.

Besniku nuk është tjetër veçse një prej atyre shumë vetëve që i preku politika. Kadareja sjell këtu edhe një numër të madh figurash dytësore, që nga fshesaxhinjtë e rrugës e deri te krerët e dikurshëm të borgjezisë që befasohen nga ngjarjet e këtij dimri të madh. Studentët shqiptarë të universiteteve të Moskës e të Leningradit janë të detyruar të ndërpresin në mes studimet e të kthehen në atdhe.

Bashkimi Sovjetik tërheq gjithë këshilltarët e vet dhe pas bisedimeve të ndera pranon të braktisë bazën e tij strategjike e jetike të nëndetëseve në Pasha Liman pranë Vlorës. Marrëdhëniet politike e ekonomike prishen përfundimisht. Dhe vërtetë, asgjë nuk ka lënë më shumë gjurmë te shqiptarët gjatë këtyre tridhjetë vjetëve të fundit se sa shkëputja nga ai përqaftim mbizotërues e mbrojtës i Nënës së Shenjtë Rusi.

*Kadareja dhe veprat: "Pallati i ëndrrave" dhe "Dimri i vetmisë së madhe"*

*– analiza, krahasime dhe interpretime*

Romani përfundon: "Në fillim të marsit, pas një ere të stuhishme, furia e së cilës ua kalonte gjithë sqotave dimërore, mijëra njerëz hipën mbi çatira dhe tarraca për të rregulluar përveç të tjerash, antenat e TV-ve, të shtrembëruara ose të rrëzuara prej saj.

Qysh nga shtatori i vitit që shkoi, një erë e tillë s'mbahej mend. Me jakat e ngritura për t'u mbrojtur nga thëllimi, njerëzit vështrojnë me vëmendje hekurat e zhveshur të antenave, sikur të kërkonin në to gjurmët e një lodhjeje të madhe. Asnjëherë gjatë jetës së tyre ata nuk kishin dëgjuar kaq shumë lajme sa këtë stinë dimri".<sup>8</sup>

Ismaili është një shkrimtar me talent. Si në veprat e tjera që ka shkruar gjër tani, edhe në romanin «Dimri i vetmisë së madhe» ka anë të mira pozitive. Të gjitha këto ngjarje, si shkrimtar, Ismail Kadareja i ka vënë në një ambient të caktuar shoqëror dhe tamam këtu ka vend për t'i bërë atij kritika, pse ka gjëra që nuk shkojnë, që nuk përfaqësojnë si duhet realitetin tonë shqiptar.

Është fakt se në atë kohë pati disa elementë tradhtarë që zhvillonin aktivitet kundër Partisë, bile deri edhe anëtarë të Byrosë Politike e të Komitetit Qendror, si: Liri Belishova e Maqo Çomo, si dhe Koço Tashko e të tjerë.

Thurjen e këtyre intrigave, ç'është e drejta, autori duhej ta ndërtonte në një ambient shumë revolucionar, ku të dilte mirë në dukje vendosmëria dhe fryma e pamposhtur luftarake e popullit tonë në atë kohë. Duhet pasur pastaj parasysh se nuk ka qenë punë aq e lehtë për të që ta trajtonte në mënyrë të përsosur këtë temë, e para e këtij lloji në letërsinë tonë artistike.

---

<sup>8</sup> Elsie, Robert, Një fund dhe një fillim, Kadare, Dimri i madh, SHB Globus, Tiranë, 1955, fq. 444



## **1.2. Bota narrative e rrëfimit**

Zhanri romanor është trajtuar si një shfaqje konkrete e modelit narrativ. Sipas teoricienit Tzvetan Todorov<sup>9</sup>, të rrëfyerit është baras me të jetuarin, pra kjo nënkupton se rrëfimi e mban gjallë personin, ndërsa mungesa e tij sjell vdekjen e prozës. Henri Xhejms, në artikullin e tij *The arts of fiction*, shprehet se rrëfimi është “një përshkrim karakteresh”, ku sipas tij, në një rrëfim gjithçka i nënshtrohet psikologjisë së personazheve.

Rrëfimi psikologjik e konsideron çdo veprim si një udhë për të njohur personalitetin e atij që vepron, si një mënyrë të të shprehurit. Veprimi në rrëfimin psikologjik është kalimtar kundrejt subjektit të vet, ndërsa rrëfimi apsikologjik karakterizohet nga veprimet jokalimtare.

Shkurtimisht do të ndalem te përbërësit kryesorë që përbëjnë strukturën e brendshme të prozës narrative: karakteristikat narrative (rrëfimore) të prozës së shkrimtarit Ismail Kadare lidhen drejtpërdrejt me objektin e kësaj teme, si dhe janë paraqitur më poshtë në formën e pyetjeve, por që gjejnë përgjigje në kërret në vazhdim të këtij punimi.

Në prozën e shkrimtarit Ismail Kadare, ashtu sikurse edhe në prozën artistike, narratori merr përsipër misionin e të rrëfyerit të ngjarjeve. Termi rrëfim ose tregim na kujton një periudhë kohore, një zhvillim e komunikim midis asaj që ndodh dhe aktantit narrativ që e përcjell atë te lexuesi. Koncepti tregimtar rrjedh nga latinishtja, narrar, që do të thotë me tregu; pra tregimtaria ka të bëjë me mënyrën sesi paraqiten ngjarjet, qofshin ato të njëmendta ose të trilluara.

---

<sup>9</sup> Todorov, Tzvetan, (2000), *Poetika e prozës*, Tiranë, Panteon-SHL, f. 44.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Rrëfimtari, ose siç quhet ndryshe edhe narrator ose tregimtar – përdorime të cilat do të gjejnë vend të tria në këtë punim – është zëri në historinë e rrëfyer, i cili qëndron jashtë tregimit, por di gjithçka rreth personazheve dhe ngjarjeve që ndërmerr të rrëfejë.

Përgjithësisht, narratori rrëfen prej një prespektive gjithëpërfshirëse, duke përfshirë mendimet dhe ndjenjat e personazheve, duke mundësuar besueshmërinë, objektivitetin në ngjarjet e rrëfyera, pra duke ‘siguruar’ vërtetësinë e asaj çka ndërmerr të rrëfejë.

Shkrimtari Ismail Kadare i dha një pamje të re e moderne prozës shqipe, në të gjithë përbërësit e vet, e sidomos në strukturimin e brendshëm narrativ. Ai theu skemat e strukturave të mendimit, si dhe format e ligjërimit artistik, duke i sjellë kështu prozës shqipe një përmasë të re, përmasën universale. Në prozën kadareane roli i narratorit nuk është thjesht të rrëfejë ndodhi që mund të kenë lidhje mes tyre, ku përfshihen personazhe, hapësira fizike e situata të caktuara. Kadareja e vendos narratorin në role nga më të larmishmet.

Ndërsa sot, teksa lexoj romanin “Pallati i Ëndrrave”, përveç ndikime të analizave që i janë bërë veprës prej studiuesve të ndryshëm, por edhe leximit për të disatën herë, nëpërmjet aluzionit e analogjisë, si dhe fjalë-termave, përveç shekullit XVIII shquaj përmes rreshtave edhe totalitarizmin komunist, shekullin XX. Po t’i referohemi qoftë edhe vetëm një fraze, arrijmë në një përfundim të tillë: “Tabir Saraj, ose siç quhet në gjuhën e sotme Pallati i Ëndrrave”.<sup>10</sup>

---

<sup>10</sup> Dado, Floresha, Narratori dhe narracioni në prozën e Ismail Kadaresë, Tiranë, 2015, fq. 31.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Autorin nuk e shohim të identifikohet me narratorin, madje edhe kur ai përdor vetën e parë. Kompetencat e lexuesit lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me interpretimin e veprës letrare. Thënë ndryshe, interpretimi lidhet me dekodifikimin e kuptimeve të fshehura në veprën letrare, pra atë çka dashur autori të transmetojë, të shprehë, sidomos në nëntekst.

Përmes interpretimit, lexuesi arrin të zbulojë kuptimet e shumëfishta të një vepre. Lexuesi i Kadaresë, përmes kompetencave të tij i jep prozës domethënie të reja e të shumëfishta. Proza kadareane duket se nuk u drejtohet ndjenjave të lexuesit, por logjikës së tij, duke i dhënë rëndësi përçimit të idesë autoriale te lexuesi.

Nëpërmjet rrëfimit subjektiv, lexuesi i zbulon personazhet për së brendshmi, si dhe futet në skutat e tij më të fshehta e të errëta, duke mundësuar njohje tërësore të këtyre karaktereve dhe thujse të gjithçkaje që i rrethon ata. Personazhi është pjesëmarrës i drejtpërdrejtë në ngjarje dhe në veprime.

Ky rrëfim krijon ngarkesa të mëdha emocionale, sepse zhvendoset në përjetimet dhe në botën e brendshme të personazhit, vetë autorit. Protagonisti vetëzbulohet dhe vendoset në raport me personazhet e tjera, kryesisht duke dialogjizuar. Rrëfimi subjektiv mbështetet në një pikëvështrim individual.

Rrëfimi i Kadaresë duket sa i njëmendtë aq edhe i paprekshëm, për të krijuar më tej një tërësi kuptimore të strukturës së përgjithshme të veprës letrare. Ky lloj rrëfimi subjektiv sintetizon reflekse semantike, si në perceptimin e rrafshit të simboleve, ashtu edhe në rrafshin e shenjave kolektive.

Narratorin me dije të kufizuar e dallojmë në romanin “Koncert në fund të dimrit”. Gjatë gjithë veprës kemi një enigmë, një mister, i cili nuk zbulohet kurrë nga asnjë prej personazheve, madje as nga lexuesi. Një prej personazheve, Ana, e cila luan një rol të rëndësishëm në kompozicionin e romanit, fsheh një sekret, që ka të bëjë me një nga lidhjet e saj në rini.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Në të vërtetë, personazhi i Ana Krasniqit (protagoniste te Koncerti...), është vazhdë e personazhit episodik të Ana Kondakçiu (te Dimri i vetmisë së madhe). Kemi të bëjmë me të njëjtin personazh, por shkrimtari Ismail Kadare parapëlqen, që në pjesën e dytë të diptikut t'i ndryshojë identitetin.<sup>11</sup>

Të gjithë njerëzit që e rrethonin Anën, e kishin të paqartë atë që cilësohej si lidhja e saj e fshehtë, madje edhe e motra e saj, Silva, me të cilën Ana hapej më tepër se me këdo për problemet e veta, ishte fare e paqartë në lidhje me të: Enigmën e lidhjes me të, as më parë, as atë ditë dhe as më vonë Ana s'e dha që s'e dha, gjersa e mori me vete në varr. Këtë mister, Ana, jo vetëm që nuk e rrëfen kurrë, por e merr me vete në varr.<sup>12</sup>

Një enigmë të tillë e hasim edhe në romanin Kush e solli Doruntinën, enigma ekziston që në titull, kemi të bëjmë me një përemër pyetës (kush). Me vdekjen e Zonjës Mëmë dhe të Doruntinës narratori shprehet: Tani enigma u bë e plotë. Nënë e bijë do ta marrin të fshehtë në varr.

Është pikërisht guri i varrit ai që kërkon ta mbajë të vërtetën për vete, në këtë rast duke ia fshehur edhe lexuesit. Këtë vepër e shoqërojnë përpjekjet që bën Stresi, pa lënë mënjane dhe personazhet e tjera, për të zbërthyer enigmën rrëfimore, e cila nis që në titull dhe mbetet e pazgjidhur deri në fund të romanit.

---

<sup>11</sup> “Koha e grindjes”, diptik: pjesa e parë Dimri i vetmisë së madhe dhe pjesa e dytë Koncert në fund të dimrit.

<sup>12</sup> Kadare, Ismail, (1988), Koncert në fund të dimrit, Tiranë, Naim Frashëri, f. 200.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Kadareja respekton vendimet e personazheve dhe të fshehtat që ata mbartin, pra ai bashkë me jetën gropos edhe të vërtetën; ky mund të jetë fare mirë një sekret rrëfimi. Kur narratori di më pak se personazhi, kjo mënyrë krijon intimitet mes treshes <sup>13</sup>:

***1. Ai që flet/rrëfen, narratori me fjalë e dije të kufizuara. 2. Ai për të cilin flitet/ndërmerret akti rrëfimor, për personazhin e Anës. 3. Lexuesi, i cili është në pritje të zbulojë sa më parë enigmën që ngërthen rrëfimi.***

Në rrafshin ‘tematik’, veprat e Kadaresë janë të gjera, çka tregon se ato bartin tiparet themelore të universit letrar kadarean. Kadareja sjell risi, sidomos në mënyrën dhe organizimin e rrëfimit, në rolin e narratorit, në procedimet e ligjërit, në pasurinë gjuhësore dhe për të gjitha elementet që ndërton zakonisht nëpërmjet gjuhës së simboleve.

Kundrimet në romanin *Koncert...*, janë të shumta, por që vërtiten rreth të njëjtit personazh, Anës dhe, së njëjtës ngjarje, lidhjes së saj enigmatike me Besnik Strugën. Njohje, e cila paraqitet që në pjesën e parë të distikut (te *Dimri i vetmisë së madhe*).

Njohja e tyre kishte ndodhur në një ditëlindje. Pra, ajo që ishte një njohje nga më të zakonshmet, që në shikimin e parë, pak kureshtar, e me disa fjalë të kursyera, kishte bërë që Ana ta dinte se do të shkonte me atë njeri <sup>14</sup>. Pra, që në pjesën e parë të diptikut, Ana paraqitet prej narratorit si një femër me sjellje të çlirët, si një femër, e cila mund t’i jepet bujarisht edhe një të porsanjohuri.

---

<sup>13</sup> Dado, Floresha, (1997), *Proza nëpër teknikat poetike*, Tiranë, Toena, f. 179.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Personazhi i Anës nuk fokalizohet në mënyra të ndryshme vetëm brenda së njëjtës vepër, në romanin Koncert në fund të dimrit, por edhe te Dimri i vetmisë së madhe. Ajo shfaqet si një personazh i mëvetësishëm, në thelb kemi të bëjmë me të njëjtën Anë, por të identifikuar ndryshe në secilën vepër (Ana Kondakçi – Ana Krasniqi). Si një prej emrave më të dashur, ndër personazhet e letërsisë botërore,

Ana rivjen edhe në korpusin kadarean. Fokalizimi i autorit-narrator për Anën është i njëtrajtshëm në të dyja pjesët e diptikut. Ajo paraqitet si një femër e cila i jepet ndjenjës në të gjitha format e saj: jeton për veten, jeton për ndjenjat, për pasionet, për kënaqësinë që i fal çasti, dashurohet pas rrezikut... Ana shfaq veprime tepër të lirshme (ishte grua e martuar e shkelëse flagrante e kurorës martesore), e mbi të gjitha ka mendësi përparimtare për kohën, duke mos menduar për askënd e për asgjë, por vetëm për veten dhe për ndjenjat e saj.

Në romanin Koncerti..., Ana paraqitet në trajtën e së vdekurës, por që vjen më e gjallë se të gjallët dhe mban peshë tërë lojën rrëfimore. Të gjitha ndodhitë lidhur me të jepen përmes retrospektivës, rrëfimi zë fill me përkujtimin e vdekjes së saj, nostalgjinë e Silvës për motrën e vdekur (efekti i suspansës në rrëfim), më pas paraqiten ndodhi të jetës së Anës.

Viktori njihete më mirë Anën, që kishte vdekur, sesa Silvën. Për të Ana ishte një grua e rrallë. Viktori njihet familjarisht me Anën, sepse bashkëshorti i dytë i saj ishte shoku i ngushtë i tij, Besnik Struga. Viktori shprehet se edhe ai ishte një djalë i mrekullueshëm, por lumturia e tyre nuk zgjati shumë.

Ky këndvështrim bie ndesh me shumicën e fokalizimeve që kishin personazhet e tjera për Anën. Ajo ishte një grua që paragjykohej së tepërmi, madje edhe nga personat që nuk e njihnin. Në rastin e Viktorit, Ana shikohet nga një fokalizues, i cili kishte lidhje familjare me të, pra e njihete fare mirë.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”  
– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Viktori ka një funksion të trefishtë kundrimi:

*Së pari, ai është vlerësues në ato çka thotë, pra opinionimi i tij për Anën është pozitiv. Së dyti, Viktori është njohës i mirë i marrëdhënies së Anës me Besnikun, sepse duke qenë mik i të dyve, është më në dijeni të lidhjes tepër misterioze (për të tjerët) të dy të dashuruarve. Së treti, perceptues, që ka të bëjë me një këndshikim të afërt pamor, sepse duke qenë pranë tyre e ka parë më nga afër ngjarjen që përflasin shumë të tjerë. Theksojmë se Ana, Viktori, Besnik Struga dhe Skënder Bermema janë personazhe edhe të romanit “Dimri i vetmisë së madhe”.*

---

<sup>14</sup> Kadare, Ismail, (1973), Dimri i vetmisë së madhe, Tiranë, Naim Frashëri, f. 477

### **1.3. Botëkuptimet e karaktereve**

Pallati i Ëndrrave, është institucioni në të cilin mbliidhen ëndrrat, përbën pallatin e tmerrit, hetimit, dhunimit e ndëshkimit të lirisë individuale – cilësuar prej narratorit si institucion hijerëndë. Detyra themelore e këtij institucioni është: me anë të kumtit që përcjellëndrra, paralajmërimi që ajo lëshon, të parandalojë fatkeqësinë e shtetit të sovranit, prandaj “Pallati i Ëndrrave” është një nga themelet e shtetit ‘perandorak’.

Spektori më i rëndësishëm i tij është interpretimi, sepse gjithçka fillon nga ky proces, i cili merret me interpretimin politik të ëndrrave. Sa më me karakter kundërpushtetar të jetë një ëndërr aq më kryeëndërr bëhet. Karriera e vërtetë e “Pallatit të Ëndrrave” fillon nga sektori i interpretimit: Interpretimi është fshehtësi mbi fshehtësinë <sup>15</sup>.

Një nga kërkesat themelore të “Pallatit të Ëndrrave” është fshehtësia e plotë: Përveç Tabirit të zakonshëm është edhe Tabiri i Fshehtë, që merret me përpunimin e ëndrrave që njerëzit nuk i bien vetë në pallat, por që shteti me anë të mjeteve dhe mënyrave të tij, i shtie në dorë.

Mënyra e organizimit të punës në “Pallatin e Ëndrrave” ka disa kërkesa kryesore: përveç punës së madhe (këtu nënkuptohet puna e madhe e PPSH-së), ka një rëndësi të madhe mbyllja e plotë e Tabir Sarajit ndaj çdo ndikimi të jashtëm (këtu nënkuptohet armiqësia që ka pasur sistemi totalitar ndaj kapitalizmit, perëndimit – ndikimeve të huaja), shumë njerëz dhe shumë rryma kanë dashur të depërtojnë këtu, por Tabir Saraji nuk ka rënë kurrë në grackë (bëhet fjalë për njerëzit që nuk janë pajtuar me diktaturën dhe janë përpjekur të dalin kundër, tjetërmendësit, disidentët).

---

<sup>15</sup> Kadare, Ismail, (1999), Pallati i Ëndrrave, Tiranë, Onufri, f. 126;



*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Kurti, ungi i vogël i Mark-Alemit, shfaq mendime liberale për kohën: nuk donte të martohej, luante golf me të birin e konsullit austriak, flitej se këmbente letra dashurie me një hanëme misterioze, me pak fjalë gjithçka e bënte tjetërllaj nga sa vepronin njerëzit në përditshmërinë e tyre. Ai, nuk ishte ngritur në asnjë post të rëndësishëm shtetëror, përkundrazi kishte hyrë në disa punë të parëndësishme, prej të cilave kishte hequr dorë shpejt, në një institucion të oqeanografisë, në arkitekturë, e kohët e fundit kishte filluar të merrej me muzikë.

Kurti, i ndryshëm prej fisit që mund të jenë brunë, ai është biond, me sy të çelët, me mustaqe të kuqërremta dhe me një emër shqiptaro-gjerman, ashtu sikurse edhe tiparet e tij fizike. Përgjithësisht linja rrëfimore në romanin “Pallati i Ëndrrave” është imagjinare, edhe pse tematika huazohet nga realiteti.

Nuk ekzistonte askund, as në hapësirën e Perandorisë Osmane e as në vendin tonë një institucion ku të mblidhen, përzgjidhen e interpretohen ëndrrat e shtetasve. Kjo gjendje afërmendsh është një lloj pasqyrimi distopik i gjendjes që po kalonte vendi ynë gjatë periudhës komuniste.

Në këtë vepër tipike distopike, nuk ekziston asnjë person (edhe ai që pretendohet se është kundër shtetit, Kurti dënohet dhe ekzekutohet), grupim shoqëror përveç shtetit, gjithçka kontrollohet e mbikëqyret prej shtetit. Kurti si antagonist, si antihero, ai sheh se çfarë është e gabuar në këtë sistem dhe përpiqet për ta ndryshuar sistemin, por pa rezultat. Mbikëqyrja e individëve përmesurvejimit të ëndrrës përbën shfaqjen më të përçudnuar të distopisë.

Ëndrra simbolizon mbikëqyrjen e shtetasve prej institucioneve shtetërore. Ëndrrat e ëndërrparësve ruhen në dosje dhe kalojnë në disa procese të posaçme për të cilat ka drejtori të veçanta në institucionin e Tabir Sarajit “Pallatit të Ëndrrave”.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Ëndrra përfaqëson ndalimin e fjalës së lirë dhe dhunimin e lirisë individuale prej shtetit, si dhe cenimin e nënvetëdijes së gjithsecilit. Ëndrra, asociacioni verbal, bëhet subjekt për censurë, të cilin mund ta quajmë “parim të besueshmërisë”,<sup>16</sup> domosdo të formuar prej vetëdijes së shkrimtarit. Ëndërrparësit janë të frikësuar të tregojnë lirisht ëndrrat e tyre.

Ëndrrat në Tabir Saraj “Pallatin e Ëndrrave” ndaheshin në gjashtë grupime, domosdoshmërisht bëhet fjalë për ato ëndrra që lidheshin me çështjet që institucioni u kushtonte rëndësi. Çdo grupim vendosej në dosje të posaçme.

Çështjet më të rëndësishme, të cilave u jepej prioritet i veçantë në “Pallatin e Ëndrrave”, përfaqësoheshin prej ëndrrave me lëndë (përmbajtje) shtetërore:

- Ëndrrat që lidheshin me sigurimin e shtetit [perandorisë te Nëpunësi...] dhe të sovranit (përbetimet, tradhtitë, kryengritjet); - ëndrrat që lidheshin me politikën e brendshme (kryesisht njëjtësia [uniteti te Nëpunësi...] e perandorisë); - ëndrrat që lidheshin me politikën e jashtme (aleancat, luftërat [abuzimet është hequr në variantin e romanit]); - ëndrrat nga jeta shoqërore [civile te Nëpunësi...] (vjedhjet e mëdha, zvetënim); - kryeëndrra - shenjimi i bashëndrës [sinjalizime për bashëndrën te Nëpunësi...]; - ëndrra të ndryshme (varia).

Thelbi i punës në “Pallatin e Ëndrrave”, punë e cila i përkiste degës së Seleksionimit, ishte që të qërohen nga dosjet ëndrrat pa vlerë, të cilat ndaheshin në tri kategori: - ëndrrat me shtysë vetjake [motive private te Nëpunësi...], të cilat nuk kanë asnjë lidhje me shtetin; - ëndrrat e shkaktuara nga uria, mbingrënia, të ftohtët, të nxehtit, sëmundjet etj., pra ëndrra që nuk kanë lidhje me mishin e njeriut.

---

<sup>16</sup> Kadare, Ismail, (2009), Vepra 11, Tiranë, Onufri, f. 280;

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Një kategorizim grotesk, pasi ëndrrat kanë lidhje drejtpërdrejt me shqetësimet njerëzore; - ëndrrat e rreme [ëndrrat kallpe te Nëpunësi...], të cilat nuk janë parë vërtet, por që janë stisur prej njerëzve për arsye karrierizmi ose të sajuara nga gënjeshtarët maniakë dhe provokatorët.

Jo vetëm individët janë të mbikëqyrur, por edhe nëpunësit ndiejnë trysni dhe frikë gjatë klasifikimit të ëndrrave, kryesisht jo në rastet kur i klasifikonin ato në “të vlefshme”, por tek ato që mund të klasifikohen si “të pavlefshme”, por që në të vërtetë mund të kenë një lidhje të drejtpërdrejtë me shtetin, më tepër se fjalimi i porsambajtur i ndonjë anëtari të qeverisë<sup>17</sup>.

Në roman theksohet se ëndrrat kishin dy stinë: gjumin dhe pagjumësinë, e ku shtetasit ishin ndarë në dy anë: shtetasit që shtriheshin në krahun lindor të shtetit (aluzioni sinekdokik – e ka fjalën për vendet e bllokut komunist) shikonin pak ëndrra, edhe ato që shikonin i tregonin me zor; dhe shtetasit që shtriheshin në krahun perëndimor të shtetit (aluzioni sinekdokik – e ka fjalën për vendet kapitaliste) shikonin shumë ëndrra dhe e kishin të lehtë t’i tregonin ato.

Shqiptarët bënin pjesë në ata popuj që i tregonin me zor ëndrrat e tyre, madje shteti kishte filluar të kapte shenjat e para të pagjumësisë. Kur Tabir Saraji kapte shenjat e para të pagjumësisë shteti merrte masa për t’i dalë përpara së keqes.

---

<sup>17</sup> Kadare, Ismail, po aty, fq. 296

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”  
– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Një prej paragrafëve me porosi kundërtotalitare botuar te Nëpunësi..., është:

*Ai po mendonte popujt që shtriheshin në krahun lindor të shtetit dhe ato të krahut perëndimor, popujt që shikonin shumë ëndrra dhe ato që shikonin pak, popujt që i tregonin ëndrrat e tyre dhe ato që nuk i tregonin, siç ishin shqiptarët (për shkak të origjinës së tij shqiptare, Ebu Qerimi padashur regjistronte ndërmend gjithçka që thuhej për atë vend) për ëndrrat e popujve që ndodheshin në robërim, të atyre mbi të cilët porsa ishin ushtruar masakrat e mëdha të popujve që ndodheshin në periudha pagjumësie. Këta të fund veçanërisht përbënin një shqetësim serioz për shtetin, sepse pas pagjumësisë gjithmonë pritej diçka befasuese. Prandaj kur Tabir Saraji sinjalizonte shenjat e para të pagjumësisë shteti merrte masa të ngutshme për t'i dalë së keqes përpara... Një popull quhet që ka rënë në pagjumësi, kur sasia e gjumit të tij është pakësuar në mënyrë drastike...<sup>18</sup>*

Edhe sintagma “Pallati i Ëndrrave”, si instancë autoriale, veç të tjerave, mund të merret si një aluzion sinekdokik, e përdorur për të shprehur një ide, por edhe dukuri edhe më të gjerë se ajo që parashtrohet paraprakisht. Ndryshimi i kuptimit këtu ndodh si marrëdhënie kuantitative, pasi ky institucion dhe gjithçka ndodh në të, barazohet me rendin qeverisës që drejton/sundon shtetasit.

---

<sup>18</sup> Kadare, Ismail. (2009) Vepra: vëllimi i njëmbëdhjetë, Tiranë, Onufri, f. 271-272;

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Krahasimi hiperbolik i funksionit të “Pallatit të Ëndrrave”, i cili ishte zyrtarizimi i mbledhjes dhe interpretimit politik të ëndrrave, përkundrejt Orakullit të Delfit dhe ëndërrshpjeguesve të famshëm romakë, asirë, persë, mongolë etj., tradita e të cilëve kishte qenë e rëndësishme, por e zbehtë në krahasim me funksionin madhështor të Tabir Sarajit.

Sipas autorit, alegoria e këtij romani quhet alegoria e ferrit totalitar, sepse nuk bëhet fjalë për Perandorinë Osmane, por për totalitarizmin komunist të vendit tonë. E kjo mund të vërtetohet lehtësisht përmes diskursit që ka përdorur autori: fjalët, emërtimet, mendësitë, ndikimet, situatat, përshkrimet, gjendjen e shtetasve, të cilat nuk i përkasin së kaluarës, por bashkëkohësisë së autorit.

Romani “Pallati i Ëndrrave” ka një “fabul” pothuajse të pabesueshme e imagjinare, pasi grumbullimi, seleksionimi dhe interpretimi i ëndrrave nga një pallat i fuqishëm, hijerëndë, ndëshkues, mbi të gjitha zyrtar, me mbështetje të drejtpërdrejtë prej sovranit, përbën një alegori të fortë, përmes aluzionit alegorik nuk kuptojmë vetëm një prej institucioneve zyrtare në Perandorinë Osmane, por përmes paraqitjes, në mënyrë të tërthortë prej autorit, kuptojmë ose më saktë nënkuptohet një tjetër domethënie, më aktuale dhe më e afërt se ajo që paraqitet:

*Jo hyrja e ndikimeve të jashtme, por përkundrazi, mbyllja e tyre, jo depërtimi, por izolimi, pra jo rekomandimi, por mosrekondimi është një nga kriteret bazë të Tabir Sarajit. Megjithatë ti sot pranohesh prej nesh në “Pallatin e Ëndrrave”, sepse pëlqehesh prej nesh <sup>19</sup>.*

---

<sup>19</sup> Kadare, Ismail, (1999), Pallati i Ëndrrave. Tiranë, Onufri, f. 16

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Një prej arsyeve të evidentimit të aluzionit alegorik në veprën e Kadaresë është edhe pamundësia për t’u shprehur hapur. “Pallati i Ëndrrave”, institucion karrierist për nëpunësit e tij: alegoria – të bësh karrierë në kurriz të të pafajshmëve, duke i mbikëqyrur dhe përndjekur ata.

Mbështetur edhe në analizat e mëparshme që i janë bërë romanit “Pallati i Ëndrrave”, por edhe nënkuptimeve kontekstuale, në këtë roman bashkërrëfhet për dy kohë relativisht të largëta, thuajse treshekullore, e çka është më e rëndësishmja, krejt të ndryshme mes tyre, si në kohë edhe në hapësirë.

Në romanin “Pallati i Ëndrrave”, përmes gjurmëve tekstore (nivelit sipërfaqësor) dallojmë se rrëfhet për të kaluarën, por, në të njëjtën kohë, si pranëvënie e së shkuarës, paraqitet edhe bashkëkohësia e autorit, jepet mbikëqyrja e shtetasve prej organeve shtetërore dhe kontrolli i çdo qelize të shoqërisë gjatë kohës së totalitarizmit komunist në Shqipëri.

Ndërthurja ose dhe përshtatja kohore në linjat narrative, thënë ndryshe adaptimi kohor, pranëvë dy sisteme të ndryshme, por të dyja tiranike: totalitarizmin osman dhe totalitarizmin komunist.

Kjo bashkekzistencë e tyre dallohet nëpërmjet përftesave gjuhësore, ku krahas barbarizmave turko-arabe shfaqen edhe fjalë, shprehje, pikëpamje, dukuri e mendësi të bashkëkohësisë së autorit, si: - Tabir Saraj: “Pallati i Ëndrrave” /Tabir Total/Tabiri i Fshehtë, - Allah: Perëndi/Zot, - mejhane: pijetore/ bufe/lokal/klub, - vezir: kryeministër etj.

***Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”***

***– analiza, krahasime dhe interpretime”***

Narratori gjatë rrjedhës rrëfimore thekson se koha e otomanëve është e largët dhe terminologjia turko-arabe është zëvendësuar me gjuhën tonë amtare, madje që në faqet e para të romanit ai shprehet se:

***Tabir Saraji, ose “Pallati i Ëndrrave”, siç e quajmë në gjuhën e sotme është një nga institucionet themelore të shtetit tonë mbretëror<sup>21</sup>.***

Si vijon po paraqesim skematikisht aluzionin eksplicit dhe aluzionin implicit për të dyja periudhat e ndryshme historike që shënjojnë në tekst: shekullin XVIII (periudha kur vendi ynë ishte nën zgjedhën e Perandorisë Osmane, por rrëfimi për këtë periudhë kohore shërben thjesht si pretekst nga ana e autorit, si mistifikim i bashkëkohësisë) dhe shekullin XX (rrëfehët edhe për bashkëkohësinë e autorit – madje bashkëkohësia është referenca kryesore /pikësnyimi i autorit).

Të dhënat e të katërta skemave janë shfrytëzuar prej të dyja varianteve, variantit të novelës (“Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”, 1980) dhe variantit romanor (“Pallati i Ëndrrave”, 2009).

---

<sup>20</sup> Kadare, Ismail, (1999), Pallati i Ëndrrave, Tiranë, Onufri, f. 16

#### **1.4. Bota imagjinare e rrëfimit**

Romani “Pallati i Ëndrrave” përfaqëson intuitën krijuese, universin imagjinar ndoshta më të larmishëm në krijimtarinë e shkrimtarit Ismail Kadare. Këto krijime autentike e përfytyrime njëkohësisht nuk përfaqësojnë vetëm krijime të kategorive leksikore por edhe krijime të kategorive konceptuale (ideore, kuptimore) duke filluar që nga institucioni i “Tabir Sarajit”, “Pallatit të Ëndrrave”, ëndërrparësve, ëndërrçuesve, bashëndërrës/kryeëndërrës etj., e duke vazhduar tek endja e ëndrrave dhe sistemi simbolik që i shoqëron e i zbërthen ato <sup>21</sup>.

I gjithë ky shqetësim vjen si referencë e së shkuarës përmes së tashmes. Edhe romanet distopike zakonisht përshkruajnë jetën në një vend imagjinar. Ku çdo gjë është tërësisht e keqe e shqetësuese pra individët ndihen gjithmonë të paqetë, ‘nuk i zë vendi vend’<sup>36</sup>. “Pallati i Ëndrrave” është pjesë e një universi imagjinar kadarean, si pjesë e fiction-it dhe, gjithashtu, shembulli më i qartë për të treguar kontrollin që ndodh në një shoqëri distopike, nën trysninë e një qeverie totalitare, të drejtuar nga diktatura e sistemit komunist.

Tabir Saraji (“Pallati i Ëndrrave”) është krijim autentik i shkrimtarit Ismail Kadare jo vetëm si krijim gjuhësor (si kategori leksikore): sintagmë emërore turko-arabe e pranëvënë në gjuhën shqipe por edhe si krijim ideor: nuk ekziston asnjë institucion së paku që të merret me grumbullimin, seleksionimin dhe interpretimin e ëndrrave të shtetasve; hiperbola – zmadhimi i dukurisë së mbikëqyrjes së ëndrrave mbi të gjithë shtetasit për të theksuar idenë e mbikëqyrjes totale dhe përndjekjes së shtetasve – të gjithë janë të rrezikuar prej ëndërr <sup>22</sup>

---

<sup>21</sup> Kadare, Ismail, Pallati i Ëndrrave, Onufri, Tiranë, 1999. fq. 129;

<sup>22</sup> Fraj, Northrop Fraj, Sabri Hamiti, Anatomia e Kritikës, Rilindja, Prishtinë 1990. fq. 371



*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Sipas kritikëve shqiptarë e të huaj “Pallati i Ëndrrave” është një aluzion për Komitetin Qendror të Shqipërisë komuniste. Do të shtonim se për sa i përket funksionit, institucioni i Pallatit të Ëndrrave mbetet një krijim i mirfilltë autentik siç theksuam edhe më lart një univers imagjinar kadarean, ndërsa për sa i përket strukturës, hierarkisë, pozicionimit gjeografik dhe sidomos kur përshkruhet si ngrehinë arkitekurore mund të përngjasojë me institucionin e Komitetit Qendror të PPSH-së, gjithashtu edhe duke e krahasuar me rolin suprem që ai zotëronte si organi më i lartë i PPSH-së, ashtu sikurse ishte edhe “Pallati i Ëndrrave” – institucioni më i rëndësishëm i shtetit perandorak i krijuar me interesimin e drejtpërdrejtë të sulltanit sovran.

“Pallati i Ëndrrave” përfaqëson institucionin më të rëndësishëm të shtetit perandorak më të vjetrin sipas mendimit të njërit prej personazheve, pavarësisht emrit të bukur që ka ai është institucioni më i tmerrshëm midis gjithë mekanizmave të shtetit, “Pallati i Ëndrrave” është ai që qëndron më jashtë vullneteve njerëzore se të gjithë të tjerët. Ai është më i tmerrshmi i të gjithëve më i verbri më fatali pra edhe më shtetërori, institucioni më absurd i perandorisë.

Do të ishte absurde në një botë logjike kurse në botën tonë mua më duket më se normale. Këto përfaqësojnë disa prej sentencave më të fuqishme e më eksplicite të novelës “Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”, ku nëpërmjet këtij institucioni, pjesa më e errët e ndërgjegjies e të gjithëve shtetasve krijon kontakt të drejtpërdrejtë me shtetin. Madje prej narratorsit “Pallati i Ëndrrave” konsiderohet si një kafaz tigrash që mbante një emër joshës por që në të vërtetë s’ ishte gjë tjetër veçse një mekanizëm i verbër fatal dhe mizor.

Puna në këtë institucion misterioz krahasohej si një punë skëterre. Institucioni misterioz i Pallatit të Ëndrrave shtie në dorë ëndrrat e të gjithë shtetasve, pa përjashtim gjithashtu është vendi ku monitorohen, hetohen dhe gjykohen ëndërrparësit e bashëndërrës/kryeëndërrës. Ëndrra dhe ankthet përbëjnë botën e vetëdijes në këtë roman kështu ëndërrparësit janë të vetëdijshëm se ëndrra për ta mund të jetë akt shpëtimi – ngritje në detyrë, shpëtimi i shtetit prej sulmeve nëpërmjet sinjaleve që kanë

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

paralajmëruar ata me anë të ëndrrës së tyre ose akt ndëshkimi, viktima të këtij mekanizmi burokratik, perms përndjekjes, dënimit e madje edhe ekzekutimit.

”Pallatin e Ëndrrave” përdorin madje mbikëqyrin një formë manipuluese të nënvetëdijes ëndrrën. Pallati i Ëndrrave monitoron shtetasit e vet në çdo çast të ditës e të natës, madje edhe gjendjen e gjumit ”ëndrrën”. Rreziku që u kanoset qytetarëve nuk mund të imagjinohet as prej tyre e as prej zyrtarëve të këtij institucioni të trishtë. Koncepti i lirisë në të gjithë kuptimet e tij duket se mungon gjithkund. Por nga ana tjetër, grotesku i lirisë është se fizikisht individët e këtij vendi janë të lirë, përveçse në rastet kur ata dënohen kryesisht për shkak të ëndrrës që mund të kenë parë. Ata “nuk” janë të izoluar nga bota e jashtme, vetëm nënvetëdija e tyre mbahet nën vëzhgim.

Njerëzit trajtohen si kavia, ëndrrat e tyre vendosen në laborator dhe ata janë aq të nënshtruar sa presin me frikë vendimin që do të merret për ta, jo nga ajo që kanë vepruar me vetëdije të plotë, sepse kjo nuk mund të imagjinohet që të ndodhë, por për atë çka mund të zbulohet nga e nënvetëdijshmja që mund t’u jetë shfaqur në ëndërr. Individët e këtij shteti totalitar janë të bindur e të nënshtruar dhe presin të frustruar vendimin për veten e tyre.

Një shoqëri e tillë nuk ka të ardhme, mbetet peng e së tashmes dhe e së shkuarës. Individët janë të kushtëzuar, të mjerë, të mbikëqyrur në vetëdije e nënvetëdije, dhe janë “të gatshëm” për të pranuar çfarëdo shteti ushtron e vendos për ta.

Në këtë roman pasqyrohen shqetësimet në rritje të sistemit komunist. Njerëzit shfaqen të tjetërsuar, individualiteti dhe të drejtat e njeriut janë kufizuara nga qeveria. Tek ata mbizotëron frika, terrori aq sa nuk mund të shohin dot as ëndrra, sepse edhe ëndrrat “monitorohen”.

## **1.5. Kultura e shkrimit**

Proza e Kadaresë luan një rol të rëndësishëm, veç të tjerash, edhe në rrafshin leksikor, në të cilin njësia bazë është fjala. Ajo është për prozatorin lënda me të cilën ai end veprën artistike. Kadareja është ndër krijuesit e trajtave dhe fjalëve të reja në gjuhën shqipe, duke e pasuruar, rifunksionalizuar dhe risemantizuar atë.

Në sprovën letrare Mosmarrëveshja: Shqipëria përballë vetvetes, shprehet se gjuha shqipe është makinë shprehëse e klasit të parë. Me të drejtë, Kadareja mund të quhet, një ndër shkrimtarët shqiptarë që rigjeneron, rigjallëron dhe rifunksionalizon gjuhën shqipe.

Në çdo vepër, madje në çdo rresht të saj, fjalët, frazat ose figurat, të përdorura mjeshtërisht prej shkrimtarit, me domethënie të posaçme janë ‘elemente’ që mund të bëhen pjesë e analizës studimore.

Pasuria leksikore që i sjell vepra e Ismail Kadaresë gjuhës shqipe është e pashtershme. Ai përdor një repertor fjalësh dhe shprehjesh, të cilat në mënyrë të veçantë, përbëjnë idiolektin e këtij shkrimtari, me tipare të ndryshme dhe të larmishme. Ligjërimi në prozën kadareane përbën një realitet gjuhësor, i cili i shërben çdo shqipfolësi.

“Fjala te ky shkrimtar fiton vlera të reja semantike dhe shprehëse, ajo merr trajta dhe forma të reja [...] gjithashtu, ajo krijon lidhje asociative me lexuesin <sup>23</sup>”.

---

<sup>23</sup> Bulo, Jorgo. (1998) Magjia dhe magjistarët e fjalës. Tiranë, Dituria, f. 19;

***Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”***

***– analiza, krahasime dhe interpretime”***

Kadareja e vendos fjalën jo vetëm në rrëfimin e rrëfimtari, por edhe në ligjërimin e personazhit. Me anën e saj, ndodh vetëzbulimi i brendshëm i personazhit, nëpërmjet dialogut ose dhe monologut, shpaloset edhe botëkuptimi i tyre. Fjala bëhet kështu filli që end rrëfimin. Si një ndër elementet më të rëndësishme të kompozicionit të veprave të Kadaresë, fjala, sipas rastit, është rrëfimtare, filozofike, semantike, psikologjike, karakterizuese, përshkruese, vlerësuese, madje edhe përcaktuese. Fjala shpesh është më tepër përshkruese se sa rrëfyese. Jo pa qëllim, shumë studiues e kanë analizuar veprën kadareane nga aspekti gjuhësor.

Studiuesit, të cilët e kanë studiuar veprën e shkrimtarit Ismail Kadare në këndvështrimin (rrafshin) gjuhësor, shprehen se:

***- Kadare pruri një tip të ri të krijimtarisë letrare në prozën e sotme, ku elementi kallëzimitar a rrëfimtari dhe elementi përshkrues vihen përballë, para fuqisë së frymëzimit të sa e sa hollësive të fjalës e të figurave artistike e stilistike letrare.***  
***- Ismail Kadareja është një fjalëkrijues gjithmonë i veçantë i etur për rrjedha të reja të fjalës ... Kadareja në përputhje me synimet e tij... mban edhe qëndrimin parapëlqyes jo vetëm ndaj fjalëve e frazeologjizmave geqe, por edhe ndaj formave fonetike të shënjuara si “jashtë normës”...<sup>24</sup>.***

---

<sup>24</sup> Çausi, Tefik; Shkurtaj, Gjovalin. (2004) Kadareja dhe fjala shqipe. Tiranë-Tetovë-Prishtinë, Albas, fq. 6;

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Risemantizimi i fjalëve dhe i trajtave të shqipe, është kthyer në një karakteristikë dhe pikësynim nga ana e autorit. Në disa prej prozave ndodh që ai të mbajë edhe qëndrim parapëlqyes ndaj fjalëve ose trajtave të caktuara, ose edhe ndaj formave fonetike, të cilat janë lënë jashtë shqipes standarde (mëkatnim, borinë etj., duke mos përdorur rotacizmin, siç thekson edhe gjuhëtari Gjovalin Shkurtaç).

Vepra kadareane i dha shpirt standardit të shqipes, Kadareja ‘aktivizoi’ dialektizma, arkaizma, fjalë nga gurra popullore etj., duke zgjeruar spektrin semantik dhe përmasën semantike të fjalës.

Pasurimi i leksikut të gjuhës shqipe me neologjizma: - arkëmort (Përbindëshi, Pallati), - foto-studio (Dimri...); - nëndhesë: bodrum (Pallati...); - tjetërmendës: për disident (Pallati...); - arkeoëndrrat: për ëndrrat e vjetra (Pallati...); - hënabrenda - hënajashtë (Pallati...); - jetëvdekja - vdekjejeta (Pallati...); - bashëndërrorët (Pallati...), i krijuar nga pjesëza bash + (mbiemri ëndërrorë nga: emri ndërr + -or, -ë, -t; ëndërrorët është formuar me mbiemrin ëndërrorë + prapashtesën -or + -t trajtëformuese; - makthdërgues (Pallati...); Fjalëformime me parashtesën mbi-: - mbingopje, fjalë e formuar nga parashtesa mbi- + foljen ngop + prapashtesa -je, jep emrin mbingopje me kuptimin i ngopur tejmase (Pallati...); - prushnajë (Pallati...); Fjalëformime me prapashtesat -ar/-tar(ë): perimtar për perimeshitës (Pallati...) Fjalëformime nga gjysmë: - gjysmëqiellor (Pallati...);

Në disa prej romaneve të shkrimtarit Ismail Kadare, si për shembull, tek Pallati i Ëndrrave, dimri i vetmisë së madhe si dhe në shumë vepra të tjera, Kadareja, nëpërmjet narratorit, i cili në këtë rast është vetë autori, merr përsipër edhe rolin e ‘gjuhëtarit’, duke analizuar jo vetëm fjalë, por edhe toponime.

## **1.6. Realiteti dhe alegoria**

Pushteti i alegorisë, nëpërmjet së cilës e Kadare godet diktaturën, është tipar mbizotërues dhe karakterizues i letërsisë dhe ndeshet kudo në prozën e tij. Njohës të veprës së Kadaresë, ndër ta edhe Arshi Pipa, që herët vunë në spikamë rebelimin dhe jokonformizimin e veprës së Kadaresë.

Romani “Pallati i Ëndrrave” shënon një kapërcim të rëndësishëm në krijimtarinë artistike të Kadaresë. Në këtë roman, shëmbëllyeshëm me letërsinë e Kafkës, Kadare ndërton absurdin letrar si simbolizëm shumëdimensional, duke trajtuar një temë historike, por ku nënteksti flet për Shqipërinë staliniste dhe utopitë që krijoi ajo ideologji.

Ndonëse ngjarja është e zhvendosur në periudhën osmane, qëllimet e autorit duken të qarta: ai ngre kambanën e alarmit nga rreziku i ëndrrave utopike. E ngritja në karrierë, rezulton të jetë absurde. Në këtë mënyrë, Kadare i jep njëëshpartisë dhe pushtetit stalinist. Kritiku amerikan Richard Eder këtë roman të Kadaresë e cilëson si nga më të mirët e autorit dhe shkruan:

“Pallati i Ëndrrave, një fantazi për burokracinë e madhe otomane që mbledh ëndrrat e njerëzve dhe ia raporton më të rrezikshmet Sulltanit. Është kjo një parabolë e përhënët mbi marrëzitë e pushtetit - vrasës e vetëvrasës në të njëjtën kohë. Por, romani është zbavitës po ashtu, dhe të pushton me tonin e pafajësisë.

“Pallati i ëndrrave” është një nga shembujt tipikë, ku zbatohet kjo vërejtje. Në vepër paraqiten dy kohë veprimi. E para, paraqet centripetalisht kohën në të cilën pasqyrohen ngjarjet që kanë të bëjnë me Perandorinë Osmane, ndërsa e dyta përmes drejtimit centrifugal, në mënyrë alegorike, zhvendos ngjarjet në bashkëkohësi, në shtetin shqiptar gjatë diktaturës komuniste.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

“Kjo është altermaniva letrare e brendshme (në vështrimin themelor) edhe e autorit edhe e letërsisë shqipe. Është gjë e njohur që në sistemet totalitare të Lindjes, shkrimtarët e kanë shpëtuar veten dhe letërsinë e vet nëpërmjet figurës, metaforës. Por, çfarë të bëhet kur temë e letërsisë do të bëhet vetë sistemi totalitar.

Kadareja këtu krijon një alegori të madhe dhe sulmon dhe përpiqet të mbrohet përmes kësaj alegorie, duke shënuar kohët e vendet e largëta, të cilat rinjohen dhe njëjtësohen për një moment. Me portretimin e shoqërisë së Njëshit e të kontrollit totalitar të jetës, të veprimit, madje të ëndrrës, Kadare ka krijuar Pallatin e ëndrrave njërën nga veprat e veta të mëdha.

Te “Pallati i ëndrrave” nuk shquhen veçori të tilla. Mund të konsiderohet më shumë “një fantazi për burokracinë e madhe otomane që mbledh ëndrrat e njerëzve dhe ia raporton më të rrezikshmet Sulltanit. Është kjo një parabolë e përhënët mbi marrëzinë e pushtetit – vrasës dhe vetëvrasës në të njëjtën kohë.

Ky rrafsh kontekstual përmes situatave paradoksale, ironike e groteske paraqet mënyrën e funksionimit të një shteti totalitar, i cili assesi nuk mund të mjaftohet vetëm me kontrollimin e vetëdijes së shoqërisë të cilën e sundon, por arrin të krijojë një institucion me rëndësi të veçantë i cili merret me kontrollin e produkteve të pavetëdijes siç janë ëndrrat.

Duke u institucionalizuar, ëndrra bëhet arma perfekte me anë të së cilës mund të eliminohet apo shantazhohet kundërshtari politik. Por krahas temës bosht rreth të cilës sillet paraqitja e Pallatit të ëndrrave, kushtimisht funksioni që luajnë ëndrrat në jetën politike të shtetit osman, qëndron edhe një motiv që zë një vend mjaft të rëndësishëm sa i përket rolit të shqiptarëve dhe pozicionit të tyre në jetën shoqëro-politike të vendit.

“Pallati i ëndrrave”, mes të tjerash, konsiderohet si një nga romanet më të bukura dhe më të guximshme të Ismail Kadaresë. Një sërë kritikësh lejimin e botimit të kësaj vepre gjatë

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

qeverisjes komuniste e kanë parë si mrekulli më vete, duke pasur parasysh shtresimet alegorike që përmban ajo. Kadare përdor çdo pjesëz të shkruar, qoftë edhe ajo edhe më e vogla, për ta vënë pastaj në funksion të qëllimit të tij primar, e në këtë rast, të “Pallati i ëndrrave”, qëllimi i tij primar është të përdorë simbolin dhe alegorinë në qendër të veprës, duke ndërtuar kështu një vepër e cila tërësisht projektohet për të sjellë përmes një teksti dy kontekste të ndryshme.

Për të siguruar një dualitet të tillë, krijohet një sistem shenjash gjuhësore të cilat udhëheqin nëpër sistemin e ndërtuar në vepër nga Kadare dhe si të tilla bëjnë të mundur edhe zbërthimin e saj përtej rrafshit të parë të paraqitur, duke kaluar në rrafshin e dytë, atë virtual. Që në shënimet paratekstuale, siç janë titulli i veprës dhe titujt e kapitujve, kuptohet se vlera dyfishe e fjalëve e si rrjedhojë e tekstit është një nga tiparet bazë të romanit.

Në “Pallatin e ëndrrave” paraqiten kryeministrat, ministrat e udhëheqësit e tjerë, të cilët sa pushtetin aq afër e kanë edhe vdekjen. Duke parë nga brenda ushtrimin e pushtetit, në shumë familje të pushtetarëve opozita më e fortë krijohet pikërisht nga anëtarët e familjeve. Kjo bëhet të qartë përmes fjalëve të Kurtit, i cili shprehet se të ndash pushtetin me dikë do të thotë në radhë të parë të ndash krimet.

Nga ana tjetër paraqiten edhe goditjet e pritura si nga njëra anë ashtu edhe nga tjetra në shërbim të mbrojtjes së interesave të tyre pushtetore. Përballja mes sulltanit dhe vezirit aludon përballjet e pashfaqura politike brenda vetë strukturave të partisë, të cilat kanë sjellë ciklone marramendëse, pushime nga puna, dosje të hapura, ristrukturime të tërësishme të organeve me ndjeshmëri politike, organizime gjyqesh, burgosje të shumta dhe varre të reja.

Duhet theksuar se pjesa më e madhe e fjalorëve si atyre të letërsisë, filozofisë e arteve dramatike, absurdin e përcaktojnë si diçka që del jashtë të menduarit logjik e të shëndoshë.



*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Ekzistenca e një institucioni si “Pallati i ëndrrave”, për më tepër roli thelbësor që luan ky institucion në jetën politike dhe shoqërore të shtetit dhe duke qenë se i tërë romani trajton temën, motive, ngjarje e rrethana, të cilat lidhen drejt për drejt me funksionalizimin dhe vendimet e tij, tregojnë se situatat absurde do dalin përtej Pallatit të ëndrrave si institucion dhe do të zënë vend në shumë pjesë të romanit. Mbledhja e ëndrrave dhe dërgimi i tyre në Pallat, përbën stadin e parë të ndërtimit të absurdit.

Duke qenë se ëndrrat, siç e kemi përmendur më lart, janë produkt i pavetëdijshëm, duke qenë se nuk shprehin veprime reale dhe si pasojë as rrezik real, duke qenë se interpretimi i tyre është tërësisht subjektiv e si pasojë jo i vlefshëm për t’u marrë parasysh, përmes absurdit paraqiten situata, që të para nga ndërtimi logjik, në dukje të parë dalin si qesharake, por që janë të ngarkuara me dozë të tillë emocionesh e të shoqëruara me një ligjërim tipik që nuk lë vend për hamendësime, por shtron përpara lexuesit ngjarje që dramatizohen e madje marrin edhe përmasa tragjike.

Aq sa është absurde ekzistenca e një institucioni të tillë, është absurde edhe rëndësia e madhe që i kushtohet rezultateve që dalin nga puna që ai bën. Megjithëse, narratori i rrëfen ngjarjet nga veta e tretë dhe nga pozita e një narratori të gjithëdijshëm, shihet se në shumë raste krijohen boshllëqe sa i përket rrethanave dhe arsyeve që çojnë në zhvillimin e mëtejshëm të disa ngjarjeve.

Natyrisht që këto nuk mund të shihen si të meta të veprës, por si zgjedhje dhe teknika të rrëfimit të cilat në mënyrë të ndërgjegjshme përdoren për të paraqitur absurditetin mbi të cilin ndërtohet jeta politike dhe shoqërore e një shteti. Ushtrimi i pushtetit deri në absurditet.<sup>25</sup>

---

<sup>25</sup> Fjalor i kritikës moderne, Toena, Tiranë 2000, f. 7

## **1.7. Lexime dhe interpretime**

Vepra e shkrimtarit Ismail Kadare përbën korpusin më të madh të një vepre artistike në letërsinë shqipe, si për veprën e shkruar në gjuhën shqipe ashtu edhe për numrin e madh të gjuhëve në të cilat ajo është përkthyer.

Deri më sot, vepra e shkrimtarit tonë të madh Ismail Kadare rezulton e përkthyer në dyzet e pesë gjuhë të huaja. Por, jo e gjithë vepra e tij ka pasur ‘fatin’ që të botohet në kohën kur u shkrua. Për këtë arsye, po paraqesim kronologjikisht vitbotimet – mbështetur në të dhënat e grumbulluara jo vetëm në veprën e botuar nga shtëpitë botuese, por edhe duke u bazuar në krijimtarinë e botuar në shtypin periodik (fejtonet) e përbri tyre edhe vitshkrimet – mbështetur në të dhënat që na paraqet autori në faqen e fundit të çdo proze.

Kemi të bëjmë me një klasifikim selektiv, pasi nuk përfshihet krijimtaria poetike, po vetëm ajo prozaike. Edhe krijimtaria në prozë përfaqësohet me pjesët më të mira të saj, gjithashtu duhet theksuar se nuk është përfshirë ajo pjesë e krijimtarisë në të cilën shkrimtari ka zgjedhur të mos e japë si të dhënë vitshkrimin, por kjo pjesë është e paktë, për të mos thënë e papërfillshme. Ky tregues i veprës, i cili mund t’i hapë rrugë edhe studimeve ose fushave të tjera kërkimore, synon të evidentojë veprimtarinë e shkrimtarit Ismail Kadare, të botuar ose edhe të shkruar. Këto të dhëna mundësojnë gjurmët zanafillore të krijimtarisë së shkrimtarit Ismail Kadare, i cili përfaqëson veprën më komplekse e më të larmishme në letërsinë shqipe.

Vepra e Kadaresë është botuar e ribotuar disa herë, si para ashtu edhe pas viteve ’90, duke mundësuar përkryerjen e saj, kryesisht në aspektin gjuhësor, estetik dhe artistik.

E përkthyer në dyzet e pesë gjuhë të huaja (anglisht, arabisht, baskisht, boshnjakisht, bullgarisht, çekisht, danisht, esperanto, estonisht, finlandisht, flamandisht, frëngjisht, greqisht, gjermanisht, hebraisht, holandisht, hungarisht, indonezisht, italisht, japonisht, katalanisht, kinezisht, koreanisht, kroatisht, letonisht, malajlamisht, maqedonisht,

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

norvegjisht, bokmal, persisht, polonisht, portugalisht, rumanisht, rusisht, serbisht, sllovakisht, sllovenisht, spanjisht, suedisht, turqisht, vietnamisht, në gjuhën arumune, malazeze, singaleze dhe në një prej gjuhëve zyrtare afrikane), vepra kadareane përfaqëson letërsinë shqipe në letërsinë botërore, sidomos në vendet ku letërsia shqipe nuk është përkthyer më parë.

Nga pikëpamja zhanrore, vepra e Kadaresë ka evoluar e është zhvilluar vazhdimisht e në çdo kohë. Kujtojmë këtu, romanin Gjenerali i ushtrisë së vdekur, botuar fillimisht si tregim ose romanin Kronikë në gur, bërthamë e të cilit shërben tregimi Qyteti i jugut, si shembujt të tjerë do të përmendnim romanin Dosja H., i botuar fillimisht si novelë, Një dosje për Homerin (1982), më pas si tregim, Dosja H. (1990) e si roman Dosja H. (1990); apo romanin Pallati i Ëndrrave, botuar fillimisht si novelë etj.

Shkrimtari Ismail Kadare shpeshherë është cilësuar si ambasadori i kulturës dhe i letërsisë shqipe në arenën ndërkombëtare. Vepra e tij shquhet për vlerat universale, duke u bërë përfaqësuese e denjë e letërsisë shqipe në botë. Si shkrimtari Ismail Kadare, ashtu edhe vepra e tij, kanë njohur vlerësime, nderime e çmime kombëtare e ndërkombëtare.

Vepra e shkrimtarit Ismail Kadare, që në fillesat e saj, ka luajtur rol të rëndësishëm në letërsinë shqipe, ky kontribut konsiston në disa aspekte:

- Vepra e Kadaresë ndikoi në formësimin e plotë të letërsisë moderne shqiptare, sidomos me prozën romanore të viteve '60-'70, duke i dhënë asaj një përmasë krejt të re;

- Me atë të veprës së Kadaresë, letërsia shqipe kaloi nga një letërsi marrëse në një letërsi dhënëse, pra proza e tij shërbeu si urë lidhëse mes letërsisë kombëtare dhe asaj botërore. Gjithashtu, Kadareja ka ndikuar, nëpërmjet veprës së tij, në njohjen e vendit tonë në arenën ndërkombëtare.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

- Shkrimtari Ismail Kadare është anëtar i denjë i familjes së letërsisë botërore. Ai përfaqëson letërsinë shqipe në shumë areale gjuhësore, duke rezultuar shkrimtari shqiptar më i përkthyer në botë, në dyzet e pesë gjuhë të huaja, nga të dhënat dhe hulumtimet mbi veprën e tij të përkthyer deri në vitin 2014.

Vepra e Kadaresë është përkthyer edhe në gjuhë të veçanta, duke u bërë e njohur e duke qarkulluar në shumë vende të botës. Vepra e tij më e përkthyer mbetet romani “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”, përkthyer për herë parë në bullgarisht, në vitin 1966, nga Marina Marinova.

Vepra e shkrimtarit Ismail Kadare, përveç gjuhëve evropiane ose edhe gjuhëve të tjera të njohura, rezulton e përkthyer edhe në gjuhë të veçanta (baskisht, esperanto, flamandisht, indonezish, katalanisht, malajlamisht, në gjuhën arumune, singaleze dhe në një prej gjuhëve zyrtare afrikane), duke e bërë të njohur letërsinë shqipe në të gjitha kontinentet. - Në vitet '70, me përkthimin e veprës së shkrimtarit Ismail Kadare në frëngjisht, letërsia shqipe, u bë e njohur në Perëndim, me përkthimin në gjuhën frënge, vepra e tij u bë pjesë e letërsisë evropiane. Romani Gjenerali i ushtrisë së vdekur u përkthye brenda vitit thuajse në të gjithë Evropën Perëndimore.

Një sukses i bujshëm për kohën, por ‘i bezdisshëm’ për Shqipërinë komuniste. Pra, në moshën tridhjetetrevjeçare, përmes përkthimit të veprës së tij, shkrimtari Ismail Kadare u bë shkrimtar me përmasa botërore. Ai gëzonte një status të dyzuar, duke qenë shkrimtar shqiptar dhe shkrimtar evropian.

Është autori që ka provuar dy epoka historike, politike e letrare, duke i dhënë kontribut të çmuar letërsisë shqipe në të dyja periudhat dhe duke sjellë risi të shumta. Krijimtaria e shkrimtarit Ismail Kadare është shkruar gjysma në komunizëm e gjysma tjetër pas rënies së tij, por vepra e tij nuk mund të periodizohet politikisht, e kjo është meritë e padiskutueshme e këtij shkrimtari.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Vepra e tij nuk i ndien ndryshimet politike që ka pësuar vendi ynë, shembulli më tipik është romani “Piramida”, i shkruar gjysma në Shqipërinë komuniste, në Tiranë, ndërsa gjysma tjetër pas rënies së komunizmit, në kapitalizëm (në Perëndim), në Paris. Koherenca e romanit bën që të mos dallohet se është shkruar në dy vende dhe në dy regjime krejt të ndryshme.

Vepra e shkrimtarit Ismail Kadare dallohet për një gjuhë artistike të nivelit të lartë, duke treguar interes të veçantë në livrimin e shqipes së kulluar dhe duke e pasuruar atë, si në rrafshin leksikor ashtu edhe në rrafshin gramatikor. Ismail Kadareja ndryshoi konceptin e dukurisë kulturore shqiptare, në saje të tematikave të larmishme që rroku në krijimtarinë e tij

Synimi i këtij nënkreu nuk është studimi i gjenezës letrare të novelës “Nëpunësi i Pallatit të Ëndrrave”, ballafaqimi i këtyre të dhënave synon të nxjerrë në pah procesin e krijimit të tekstit artistik gjatë linjave narrative, duke mos e parë tekstin si të mbyllur në vetvete.

Nëpunësi... përbën shembullin e atyre veprave që ripunohen e rimerren prej autorit. ‘Rishkrimi’ i tij në variantin “Pallati i Ëndrrave” vjen i ndryshuar për lexuesin, jo nga pikëpamja botëkuptimore dhe tematike, por sidomos nga pikëpamja gjuhësore, si ‘përkryerje’ artistike, edhe pse në të ekzistojë pasazhe të tëra të pandryshuara. Ndryshimet e rrafshit gjuhësor, edhe pse janë të shumta, nuk e kanë tjetërsuar veprën në zanafillë të saj.

Hetimi i procesit të krijimit dhe të rikrijimit të tekstit kadarean, nuk është objekt studimi i këtij punimi. Ribotimet e Nëpunësit... dhe të Pallatit... përbëjnë fushë më vete studimore, si pjesë e variantistikës, dhe janë pikësynime për studime të tjera të mëvonshme.

## **1.8. Dialogu dhe monologu narrativ**

Romani distopik (dystopian fiction) është një lloj zhanri në të cilin pasqyrohen strukturat sociale dhe politike të një vendi, nën mbikëqyrjen e sistemeve totalitare, burokracive ose edhe kompanive të caktuara.

Në letërsi, distopia është pjesë e fiction-it, ku gjithashtu ajo lidhet me një vend imagjinar ku jeta është jashtëzakonisht e keqe për shkak të privimit, shtypjes, mbikëqyrjes ose dhe terrorit. Në romanet distopike nuk përshkruhet një vend ku njerëzit do të donin të jetonin, përkundrazi, një vend në të cilin duhet shmangur jeta.

Veprat distopike theksojnë trysinë që ndodh për shkak të kushteve politike, e ku shoqëria është një shoqëri tipike distopike. Temat kryesore në një vepër distopike janë: shtypja, mbikëqyrja dhe rebelimi. Mjedisi luan një rol të rëndësishëm në pasqyrimin distopik. Rrëfimet distopike, zakonisht janë rrëfime për mbijetesë, e ku përgjithësisht rrëfimi shfaqet si imagjinar, edhe pse tematika huazohet nga realiteti. Në një vepër tipike distopike nuk ka asnjë grup shoqëror përveç shtetit, por edhe nëse ka, ato janë të kontrolluara prej shtetit.

Romanet distopike trajtojnë, gjithashtu, idenë e klasës dhe të lirisë. Është gjithmonë shtresa elitare, kryesisht ajo në pushtet, që komandon dhe u ndalon lirinë shtetasve të vet. Institucioni i “Pallatit të Ëndrrave” ishte një prej atyre ku edhe ministrat hynin me leje të veçantë. Institucion zyrtar ku, portierët, kupolat e ngrehinës, një pjesë e mureve, kapakët e dosjeve kanë të njëjtën ngjyrë, gurrkali të zbehtë.

Distopia në romanin “Pallati i Ëndrrave” është e frikshme, tmerruese, e ankthshme, prandaj ndodh kontrolli deri tek ëndrrat që shohin njerëzit, në mënyrë që të shmangen përpjekjet prej individëve të ndryshëm për të shpëtuar ose, edhe më e keqja, për të shkatërruar distopinë. Në institucionin e “Pallatit të Ëndrrave” punohet fort që kjo gjë mos të ndodhë, duke parandaluar ngjarje të tilla.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Në romanin “Pallati i Ëndrrave” janë analizuar disa prej karakteristikave të romanit distopik. Në teorinë e letërsisë, distopia lidhet me një vend imagjinar apo shtet në të cilin gjendja e jetës është jashtëzakonisht e keqe, si nga privimi, shtypja ose dhe terrori – nën këtë këndvështrim, është analizuar romani “Pallati i Ëndrrave”, i cili përfaqëson vendin “imagjinar” në të cilin ndodh procesi i përpunimit të ëndrrave, i ndarë në sektorë të posaçëm.

Në roman jepet mbikëqyrja totale e shtetasve nga ana e qeverisë komuniste. Është arritur në përfundimin se këta nuk janë sektorët e përpunimit të ëndrrave, në tekst rrëfëhet për të kaluarën, për shekullin XVIII, por janë procese të mbikëqyrjes, të hetimit dhe të vëzhgimit të shtetasve në bashkëkohësinë komuniste nga pushteti totalitar, pasi në nëntekst gjurmët të çojnë në shekullin XX. Shtetasit e këtij vendi janë të kufizuar e të kushtëzuar nga qeveria, dhe tek ta mbizotëron frika, ankthi, terrori, aq sa kanë frikë të shohin edhe ëndrra.

Jo vetëm romani “Pallati i Ëndrrave”, por, në përgjithësi, të gjitha romanet dispotike janë shkruar në përgjigje të shqetësimeve politike. Veprat distopike theksojnë trysninë që ndodh për shkak të kushteve politike, vepra, të cilat paraqesin jetën, jo vetëm të një individi, por të një shoqërie të tërë nën mbikëqyrjen ose trysninë e qeverive totalitare.

Te Kadareja, shteti është mbikëqyrësi kryesor i jetës së shtetasve të vet, shoqëria është një shoqëri tipike distopike, gati një shoqëri paranojake, ku veprimet shtetërore shkelin të drejtat themelore të njeriut. Paraqitet mbikëqyrja totale nga ana e qeverisë, e ky është shqetësimi kryesor që autori parashtron në këtë roman; shqetësim, i cili lidhet me përndjekjen dhe ruajtjen e të dhënave vetjake të gjithsecilit prej strukturave më të larta shtetërore.

Një vepër distopike lidhet ngushtësisht me shoqërinë së cilës i drejtohet, kështu që varianti fillestar përbën një interes të veçantë nga ana studimore, për rastin distopik, sepse

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

përfaqëson veprën e parë të botuar me porosi kundërtotalitare në regjimin monist. Duke konfrontuar të dyja tekstet, variantin e botuar në përmbledhjen me novela Gjakftohtësia dhe botimin e mëvetësishëm si roman, është vënë në dukje se ky ballafaqim nxjerr në pah, e mbi të gjitha dëshmon për elementet distopike të veprës; elemente eksplicite, të cilat gjejnë vend pothuajse në çdo faqe të novelës.

Në romanin “Pallati i Ëndrrave” përshkruhet vendi ku grumbullohen ëndrrat, Tabir Saraji, ky vend imagjinar i krijuar prej imagjinatës autoriale dhe i shfrytëzuar prej tij për të denoncuar politikën totalitare të periudhës komuniste. Njerëzit gjenden në kthetrat e një sistemi që mund të bëjë gjithçka do dhe për këdo, dhe ajo çka është më e rëndësishmja është se gjendja distopike shpesh mbetet e pazgjidhur.

Në veprën e Kadaresë, shteti është mbikëqyrësi kryesor i jetës së shtetasve të vet, ky roman, ashtu sikurse shumica e romaneve distopike janë shkruar në përgjigje të shqetësimeve reale politike, për shkak të të cilave cilësitë e jetës janë të pakëndshme, pra e kundërta e utopisë.

Shoqëria në këtë roman është një shoqëri tipike distopike, në të cilën: mbledhja, përpunimi dhe interpretimi i ëndrrave përdoret për të kontrolluar individin; informacioni, mendimi i lirë, shprehja e tij dhe liria janë të kufizuara, madje të pakonceptuara; qytetarët perceptohen të jenë nën mbikëqyrje të vazhdueshme; qytetarët kanë frikë prej botës së jashtme dhe të brendshme, kanë frikë prej të pandërgjegjshmes së vet – ëndrrës; qytetarët jetojnë në një shtet ku mungojnë vlerat minimale humanitare; individualiteti, kundërshtimi dhe rebelimi ndaj regjimit kanë pasoja tragjike – rasti i Kurtit; shoqëria propagandon iluzionin e një bote të përsosur utopike, por që në të vërtetë s’është veçse një shoqëri tipike distopike, ku paranoja është tipar i qartë në mesin e qytetarëve, të cilët jetojnë në frikë, duke u ndierë të mbikëqyrur ose edhe të manipuluar prej sistemit politik.

Në letërsi, një shoqëri distopike është një shoqëri që ka degraduar nga një shtet shtypës dhe mbikëqyrës, shpesh nën maskën e të qenit shtet utopik. Letërsia distopike shërben për



*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

të paralajmëruar shoqërinë se këto kushte shkaktojnë pasoja të pashlyeshme. Veprat disopike përshkruajnë format totalitare të qeverisë. Paranoja është një prej tipareve dalluese të individit në romanet Pallati i Ëndrrave të Ismail Kadaresë dhe 1984 të George Orwell-it; romane, të cilat përbëjnë shembujt më ekstremë të paranojës.

Në romanin Pallati i Ëndrrave, individët janë të ndikuar, ose më saktë jetojnë me ankthin, kërcënimin dhe frikën e përndjekjes e të mbikëqyrjes prej institucioneve qeveritare, edhe pse nuk kanë bërë asnjë në kundërshtim të qeverisë. Marrja e ëndërrparësve në pyetje, akuzat e paqena, bindjet për komplete ndaj shtetit, kërcënimet janë tiparet kryesore që i bëjnë këta individë paranojakë.

Në radhë të parë, paranojakë janë udhëheqësit politikë (kryeëndrra/bashëndrra kërkohet me porosi të sovranit), të cilët orvaten të kapin sjelljet aksidentale të shtetasve, nëse do t'i quanim ëndrrat e Pallatit të Ëndrrave si të tilla, dhe duke i përkthyer ato si sjellje të qëllimshme, madje edhe kërcënuese për shtetin.

Është e sigurt, se nëse Enver Hoxhës i njihet merita e largimit të sovjetikëve nga baza ushtarako-detare e Vlorës, atëherë, pavarësisht të këqijave që ka bërë, bilanci i të mirave dhe të këqijave të tij del gjithsesi me një kredit të mirash, si për perëndimorët, ashtu dhe për shqiptarët.

Ismail Kadare e di se nëse e mbron Enver Hoxhën në këtë pikë, atëherë, pavarësisht nga kritikën që i ka bërë, i ka bërë shërbimin më të madh bashkëqytetarit të vet gjirokastrit, në pikëpamjen historike afatgjatë. Këtë Kadare e bën edhe për të mbrojtur librin e vet «Dimri i vetmisë së madhe» («Dimri i madh»). Por, si është e vërteta?

Në romanin e vet «Dimri i vetmisë së madhe» (1973), Kadare e sjell kështu dialogun e mësipërm Enver Hoxha-Hrushov për bazën e Vlorës:

«Gjatë kohës që proverbi u përkthye në dy-tri variante, krejtësisht të pangjashme me njëri-tjetrin, dikush përmendi grindjet në bazën e Vlorës.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

- Në qoftë se baza sjell grindje, ta heqim, - tha Hrushovi.
- Si të doni, - tha Enver Hoxha. - Qenia e Pasha Limanit do të thotë që në rast lufte, të digjet më parë Vlora se Sevastopoli.
- Ç’është ky Pasha Liman? - tha Hrushovi.
- Kështu quhet ndryshe baza, - i shpjegoi me zë të ulët Mikojani.
- Hm, - ia bëri Hrushovi. - Ç’emër i tmerrshëm. Po të doni ne mund t’i heqim nëndetëset, - tha ai. - Ato janë tonat.
- Baza është e përbashkët, - tha Enver Hoxha».<sup>26</sup>

Romani i Ismail Kadaresë, si në versionin «Dimri i vetmisë së madhe», ashtu dhe në atë «Dimri i madh» ka si bosht të suspansit konfliktin shqiptaro-sovjetik për bazën ushtarake të Vlorës. Derisa në Vlorë gjendeshin forca ushtarake sovjetike, atëherë konflikti ideologjik mes Shqipërisë dhe Bashkimit Sovjetik duhej pritur të precipitonte në Vlorë, të cilën sovjetikët mund ta përdornin si kryeurë për të ndërhyrë ushtarakisht në Shqipëri, sië bënë në Hungari në 1956 dhe në Çekosllovakia më pas, duke përfituar nga fakti se Shqipëria ishte vend anëtar i Traktatit të Varshavës.

Në romanin e Kadaresë, tjetërsohet krejtësisht e vërteta historike, sipas konvenimit të regjimit komunist të Enver Hoxhës, gjë që bëhet madje edhe duke kundërshtuar dhe dokumentet e botuara nga vetë Enver Hoxha.

---

<sup>26</sup> Ismail Kadare: «Dimri i vetmisë së madhe», «Naim Frashëri», Tiranë, 1973, f. 148.

## **2. QËLLIMI I HULUMTIMIT**

Në kuadër të këtij punimi të magjistraturës, do të përpiqem të tërheq një paralele midis stilit të shkruar e të shprehur të autorit të madh të letrave shqipe Ismail Kadare, i cili me botimin e romaneve: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, në periudhën prej viteve 1971-1981, paraqet një nga krijimet kulmore të tij, për të cilat letërsia evropiane, jo rrallë e vendoste autorin e tyre në listën e kandidatëve për çmimin “Nobel”, që nuk arriti ta gëzoj deri tani.

Gjithashtu, si qëllim i punimit është të hulumtoj se çka e motivoi Kadarenë, të bëjë një rrugëtim dhjetë vjeçar nga “Pallati i ëndrrave” deri te “Dimri i vetmisë së madhe”, të nxjerr në sipërfaqe botëkuptimit, që i karakterizojnë veprat në fjalë, duke aluduar në ngjarjet që zhvillohen brenda tekstit, konstruktet brenda dialogut, bota e rrëfimit dhe në pikëpamjet estetike të autorit.

Në kuadër të këtij punimi do të nxirret në spikamë gjuha e ashpër alegorike e autorit, të shkruar gjatë kohës së diktaturës, ferrit të kuq komunistë, që tjetërsonte individin dhe shkatërronte konceptin e qytetarisë kolektive.

Rëndësia e këtij punimi është se kemi të bëjmë me dy vepra madhore të letrave shqipe, që kanë për autor një nga personalitetet më të shquara të kulturës shqiptare dhe evropiane Ismail Kadare, të cilin lexuesit dhe kritika letrare e njohin si njërin nga krijuesit më të mëdhenj botëror.

“Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, janë vepra thelbësore të Kadaresë, njërat nga më të përfolurat dhe më të analizuarat nëpër periudha të ndryshme kohore, duke nxjerr në opinion botën e pasur letrare, artistike e narrative, me një stil të lartë shkrimor dhe me një kulturë të pasur gjuhësore e ideore.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”  
– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Ky punim do ta ketë rëndësinë e hartimit, për vet faktin se ka të bëjë me dy romane nga më të rëndësishme të autorit Kadare, Kadare njihet si shkrimtar i cili në veprat e tij në mënyrë të qëllimshme u shmang nga realizmi socialist, dhe si i tillë veprat e tij u përkthyen dhe u lavdëruan nga kritikët dhe lexuesit anembanë botës. Ai krijoi një vepër me karakter universal por që rrënjët i ka thellë në tokën shqiptare. Kadare konsiderohet nga disa si një nga shkrimtarët dhe intelektualët më të shquar evropianë të shekullit të 20-të, si dhe një zë universal kundër totalitarizmit.<sup>27</sup>

Kërkimet hulumtuese për veprën e shkrimtarit Ismail Kadare ose dhe analizat kualitative të çështjeve të përcaktuara qartë në këtë punim, janë bazuar përgjithësisht në shfrytëzimin e disa burimeve, si:

- të dhënave parësore (romanet “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, të Ismail Kadaresë); dhe
- të dhënave dytësore, siç janë: shfrytëzimi dhe konsultimi i literaturës së posaçme në bibliotekat përkatëse, qoftë edhe shfrytëzimi i literaturës elektronike (EBook).

Studimi i prozës kadareane dhe qasja teorike vjen si nevojë e shfrytëzimit të: kritikës letrare, studimeve dhe artikujve studimorë, si edhe shqyrtimi i librave të teoricienëve bashkëkohorë.

---

<sup>27</sup> Marrë nga Wikipedia.

### **3. METODAT E STUDIMI**

Për punimin e temës së magjistraturës me titull: “Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe” – analiza, krahasime dhe interpretime do të përdor:

- Metodën komperative (krahasuese);
- Metodën teorike;
- Metodën deskriptive;
- Metodën analitike

Për të realizuar këtë temë magjistrature na kanë ardhur në ndihmë disa metoda studimi. Si fillim metodën e krahasimit, e cila është një metodë që na ka shërbyer për të krahasuar elementet e romanit, veçoritë e përbashkëta dhe dallimet, të cilat na kanë dalë gjatë studimit të kësaj teme. Një krahasim i “Pallatit ë ëndrrave”, para, gjatë dhe pas periudhës së komunizmit.

Duke përdorur metodën krahasimtare kemi ardhur në përfundim se Kadare me plot vetëdije u drejtohet dy narraterëve, dy llojeve të lexuesve, të të dy kohëve. Mirëpo, me ndërtimin e një paralelizmi lexuesish Kadare e ka fshehur, aq sa ka mundur, objektin e trajtimit të tij: totalitarizmin në totalitarizëm, dhe e ka deklaruar një objekt analog, Perandorinë Osmane. Pra, Kadare godet Perandorinë Osmane me ironinë e tij, duke krijuar kështu veprën letrare më ironike dhe, njëkohësisht më antitotalitare të letërsisë shqipe: një jetë të drejtuar plotësisht nga ëndrrat.

“Pallati i Ëndrrave” i Ismail Kadaresë gjatë periudhës së komunizmit interpretohej se ishte kundër Perandorisë Osmane, ndërsa vetëm pas rënies së komunizmit filloi të interpretohet si kundërkomuniste.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Interpretohej kundër Perandorisë Osmane sepse: i drejtohej aq drejt Perandorisë Osmane, personazhet kishin emra turkë; kryepersonazhi quhej Ebu Qerim, pastaj aludohej për një pallat që kishte emër turk “Tabir Saraj”, por edhe se personazhet kishin emra turkoarabë: Mehmet Qyprilliu, Fazil Ahmet etj.

Megjithëse kishte këto elemente, vepra nuk i shpëtoi censurës. Ajo u lexua nga bashkëpunëtorët e sistemit, dhe e pësoi anatemin. Duhet ditur se “Pallati i Ëndrrave” kurrë nuk u botua si i plotë në kohën kur u shkrua. Autori ishte i vetëdijshëm se alegoria në romani i tij do të dallohej nga sistemi totalitar komunist.

Vetëm pas rënies së komunizmit Kadare i (ri)kthehet veprës së ndaluar, kryeveprës ironike të letërsisë shqipe, dhe kështu e afishon dhe e rindërton atë, ku tash e shpreh pa cenzurë atë që ka dashur ta thotë vërtet me veprën e tij të shkruar në totalitarizëm e kundër totalitarizmit.

Mundësia që romani i Kadaresë, sidomos “Pallati i Ëndrrave”, të lexohet (interpretohet) në dy kohë; roman kundër Perandorisë Osmane; roman kundër totalitarizmit, pra një vepër që në plan të parë sulmon Perandorinë Osmane por në plan dytësor aktualitetin totalitar, bën që vepra e Kadaresë të lexohet vazhdimisht. Po kështu, është pikërisht ky element që edhe këtë vepër e bën ndër veprat më të arrira të këtij shkrimtari, por edhe veprën më antitotalitare të shkruar në totalitarizëm<sup>28</sup>.

Shumica e studiuesve të Kadaresë “Pallatin e Ëndrrave” si vepër antitotalitare ndaj komunizmit e interpretuan vetëm pas rënies së sistemit, ndërsa gjatë sistemi, nga shumica e studiuesve vepra interpretohej si kundër Perandorisë Osmane. Kjo, pra, paraqet edhe kahjet e studiuesve nga dy periudhat.

---

<sup>28</sup> Ismail Kadare: Pallati i Ëndrrave, Botimi i dytë, Roman, Onufri 2011.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Është fakt se pak pas botimit të plotë që do të konsiderohej i pazakontë dhe i pajustificuar, romani u shndërrua në një “çështje” letrare që i detyroi krerët e shtetit dhe të partisë të merrnin masa duke zbatuar metodat represive që hynin mekanikisht në veprim për t’i prerë rrugën së ashtuquajturës “veprimtari armiqësore kundër shtetit”<sup>29</sup> .

Ishte e qartë se Kadare nuk e kishte për objekt të romanit obsesionet e institucionalizuara të “perandorisë” osmane por reagimet e sistemit socialist shqiptar, obsesionet dhe makthin e atyre që i vuanin ato. Nuk është vendi këtu për një analize ngushtësisht letrare të Nëpunësit të “Pallatit të Ëndrrave”, por nuk mund të mos themi se këto vlerësime janë të domosdoshme për të kuptuar zhvillimet e mëvonshme të historisë së këtij teksti, si edhe të veprave të tjera të Kadaresë që u dënuan të pësonin të njëjtin fat posa që variantet që do të botohen nga ky çast deri në rënien e regjimit u imponuan përmes ndërhyrjes së “kontekstit”<sup>30</sup> .

Institucionet qeveritare të përfaqësuara në këtë rast me më kryesorin, “Tabir Sarajin”, ”Pallatin e Ëndrrave” përdorin madje mbikëqyrin një formë manipuluese të nënvetëdijes ëndrrën. Pallati i Ëndrrave monitoron shtetasit e vet në çdo çast të ditës e të natës, madje edhe gjendjen e gjumit ”ëndrrën”.

Rreziku që u kanoset qytetarëve nuk mund të imagjinohet as prej tyre e as prej zyrtarëve të këtij institucioni të trishtë. Koncepti i lirisë në të gjithë kuptimet e tij duket se mungon gjithkund. Por nga ana tjetër, grotesku i lirisë është se fizikisht individët e këtij vendi janë të lirë, përveçse në rastet kur ata dënohen kryesisht për shkak të ëndrrës që mund të kenë parë. Ata “nuk” janë të izoluar nga bota e jashtme, vetëm nënvetëdija e tyre mbahet nën vëzhgim<sup>31</sup> .

Njerëzit trajtohen si kavie, ëndrrat e tyre vendosen në laborator dhe ata janë aq të nënshtruar sa presin me frikë vendimin që do të merret për ta, jo nga ajo që kanë vepruar me vetëdije të plotë, sepse kjo nuk mund të imagjinohet që të ndodhë, por për atë çka mund të zbulohet nga e nënvetëdijshmja që mund t’u jetë shfaqur në ëndërr.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Individët e këtij shteti totalitar janë të bindur e të nënshtruar dhe presin të frustruar vendimin për veten e tyre.

Një shoqëri e tillë nuk ka të ardhme, mbetet peng e së tashmes dhe e së shkuarës. Individët janë të kushtëzuar, të mjerë, të mbikëqyrur në vetëdije e nënvetëdije, dhe janë “të gatshëm” për të pranuar çfarëdo shteti ushtron e vendos për ta. Në këtë roman pasqyrohen shqetësimet në rritje të sistemit komunist. Njerëzit shfaqen të tjetërsuar, individualiteti dhe të drejtat e njeriut janë kufizuara nga qeveria. Tek ata mbizotëron frika, terrori aq sa nuk mund të shohin dot as ëndrra, sepse edhe ëndrrat “monitorohen”.

Madje Shqipëria sipas autorit është një vend ku sundon stina e pagjumësisë, ndërsa shqiptarët janë një popull që kanë frikë t’i tregojnë ëndrrat e tyre – kanë frikë të shprehin hapur mendimin e tyre dhe të shprehen lirshëm<sup>32</sup>.

Ëndrrat ruheshin në dosje, e cila u përngjante dosjeve të proceseve gjyqësore. Dosjet mbanin përsipër vulën mbretërore. Përpunimi i ëndrrave është i ngjashëm me procesin hetimor, madje nga termi dosje kalohet në procesverbal.

Koherenca e romanit bën që të mos dallohet se është shkruar në dy vende dhe në dy regjime krejt të ndryshme.

Metodën e përshkrimit, metodën teorike dhe metodën analitike i kemi përdorur përmes detajeve të gjetura në roman kemi përshkruar karakteristikat kryesore të personazheve të romanit “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”.

---

<sup>29</sup> Ardian Ndreca: Kadare, leximi dhe interpretimi, ese dhe studime në tetëdhjetëvjetorin e lindjes, Onufri 2016.

<sup>30</sup> Matteo Mandala: Për një botim kritik të Nëpunësit të pallatit të ëndrrave, shënime

<sup>31</sup> Ismail Kadare: Pallati i ëndrrave, Onufri, Tiranë 1999. fq. 131

<sup>32</sup> Northrop Fraj, Sabri Hamiti: Anatomia e Kritikës, Rilindja, Prishtinë 1990. fq. 372



#### **4. REZULTATET**

Nga hulumtimet e elementeve të edukimit kritik, kreativ dhe estetik në prozat e Ismail Kadaresë, kemi arritur një përfundim se Kadare ka talent të jashtëzakonshëm për ta mbajtur pezull lexuesin duke e shëtitur mjeshtërisht nëpër kohë dhe hapësirë. Dhe bashkë me galerinë mahnitëse të personazheve të tij lexuesi zbulon gjithmonë mënyra të reja të perceptimit të universit tonë. E duke pasur si topose temat e dramat ballkanike, autori atyre gjithmonë iu jep një përmasë homerike të rrëfimit ku konflikti është gjithmonë prezent e ku domosdoja që ai të zgjidhet është në përkim me kërkesat e artit letrar, drejt efekteve të katarsisit.

Për shkak të aluzioneve të hapura kundër regjimit komunist, në mars të vitit 1982 u thirr në mënyrë urgjente një plenum i Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë ku morën pjesë edhe zyrtarë të lartë si Ramiz Alia dhe Nexhmije Hoxha. Aty romani "Pallati i ëndrrave" u dënua ashpërsisht kurse Kadare u akuzua se në roman kishte futur aluzione kundër regjimit komunist në Shqipëri duke i thënë që ishin në dijeni se "Pallati i Ëndrrave" ishte në fakt Komiteti Qendror i PPSH-së.

Pos tjerash, autori u akuzua se kishte bërë sulme të fshehta ndaj sistemit socialist dhe izolimit të Shqipërisë. Si rrjedhojë romani u ndalua. Prej një arrestimi të mundshëm autori shpëtoi falë njohjes ndërkombëtare. Në vitin 1980 me rastin e botimit të romaneve "Prilli i thyer", "Kush e solli Doruntinën" dhe "Dasma në një vëllim të përbashkët", Kadare shfrytëzoi rastin dhe i futi aty edhe dy kapitujt e parë të romanit "Pallati i Ëndrrave". Për shkak të tematikës që dukej si historike nuk u tërhoqi vëmendjen kritikëve.

Një vit më vonë me rastin e ribotimit të një përmbledhjeje tregimesh autori e shfrytëzoi rastin dhe e futi në të romanin e plotë pa u vërejtur nga censura zyrtare e cila pasi i kishte dhënë një herë dritën e gjelbër botimit tani kishte e ngritur vigjilencën. Pas botimit njerëzit filluan të vërenin ngjashmëri mes përshkrimeve të qytetit ku luheshin ngjarjet në

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

roman dhe Tiranë. Disa veçori të “Tabir Sarajit” u kujtonin njerëzve ndërtesën e Komitetit Qendror të PPSH-së. Edhe atmosfera e terrorit në roman të kujtonte atmosferën e terrorit në Shqipërinë e Enver Hoxhës. Binte në sy edhe fakti që autori nuk kishte provuar aspak ta bënte romanin historikisht të saktë, përkundrazi në të kishte anakronizma të shumta qëllimi i të cilave ishte ta bënin ngjarjen të tingëllonte aktuale. Kur e lexojmë veprën e Kadaresë ne pyesim “a ndikon letërsia që ta kuptojmë një ide tjetër për historinë?” E përgjigjen e jep vepra e tij e pasur e cila dëfton se letërsia dhe ligjërimi letrar ka vlerë që të dëshmojnë një ide tjetër për historinë dhe kulturën.

Kadare me veprën e tij krijoi hartën kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve dhe ajo përfaqëson kombin shqiptar anekënd botës. Ai shkroi tekste artistike të predestinuara për t’u rezistuar kohëve dhe për t’u hyrë në përjetësi. Sepse krijimtaria artistike e Kadaresë e jep një alternativë të përhershme për Shqipërinë komuniste dhe jo vetëm për të. Ajo e jep një alternativë të përhershme për Shqipërinë kulturore e shpirtërore.

Nga penda e tij mjeshtrërore e kuptojmë më mirë edhe Shqipërinë kulturore dhe identitetin e saj të lashtë, të thadruar përbrenda në një vepër letrare me peshë dhe shtrirje planetare t’i identifikojmë vlerat e larta edukuese e moralizuese, që kanë prozat e shkurta, kushtuar botës së fëmijëve.

Në këtë drejtim, gjithashtu, duke shfrytëzuar metodën e hulumtimit, në mes të romanit “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, kemi gërshetuara elementet e përbashkëta nga të cilat del një mesazh i qartë dhe karakter edukimi dhe afirmimi.

Rezultatet dhe rëndësia e këtij punimi, konsistojnë në faktin se rezultatet e hulumtimit do të jenë të vlefshme për studiuesit e ardhshëm, për të fituar një pasqyrë më të qartë rreth afirmimit të këtyre vlerave artistike, që kanë prozat e të madhit tonë Ismail Kadare. Sidoqoftë, rezultatet pozitive të edukimit të brezave të rinj, përmbledhin dimensionin më të fuqishëm të këtij punimi, i cili tregon haptazi për vlerat e krijimeve të poetit dhe shkrimtarit Ismail Kadare.

## **5. BIOGRAFIA**

Ismail Kadare u lind, më 28 janar 1936, në Gjirokastrë. Në vitin 1974, në moshën 12 vjeçare arrestohet nga regjimi i sapo vendosur komunist nën akuzën “falsifikim monedhash”, meqë gjatë lojës me shokun e tij kishin krijuar me plumb të shkrirë monedha 5 – lekëshe dhe ua kishin treguar gjithkujt me hare.

Policia i arrestoi gjatë orës së mësimit në shkollë, dhe Ismaili bëri dy ditë burg derisa ndërhyri avokati i Kadarenjve dhe e liruan për shkak të moshës së mitur. Si ndëshkim në shkollë iu thye nota e sjelljes nga pesë në tre. Më vonë do t’i përshkruante këto ndodhi në novelën “Koha e parasë”.

Në moshën trembëdhjetë vjeçare zbuloi Makbethin një ndër veprat e Shekspirit dhe kështu lindi dashuria për letërsinë. Tregimin e parë, të titulluar “Në dheun e huaj” e shkroi në vitin 1953. Gjatë kësaj kohe botoi vëllimin poetik “Frymëzime djaloshare”(1954), ndërsa tri vjet më vonë, më 1957, botoi vëllimin tjetër poetik me titull “Ëndërrimet”.

Studimet universitare i kreu në Tiranë, ku më 1958 mbaroi degën e Gjuhës e Letërsisë në Universitetin e Tiranës. Gjatë qëndrimit në Moskë në nëntor 1959, shkroi romanin e parë “Qyteti pa reklama”, duke sfiduar qëllimshëm rregullat e realizimit socialist. Për shkak të temës delikate të romanit që bënte fjalë për studentë të shturur e amoralë që arrijn suksesin me anë të falsifikimeve, e që ishin në kundërshtim të plotë me frymën pozitive e heronjtë pozitivë që proklamonte realizimin socialist, romani mbeti pa u botuar.

Pas kthimit nga Moska i tregoi një mikut të tij i cili e këshilloj që ta mbante të fshehur e të mos ia tregonte askujt. Në vitin 1961 botoi një vëllim me poezi me titull “Shekulli im” ndërsa më vonë e përpunoi një fragment nga romani “Qyteti pa reklama” ashtu që të dukej si novelë, i vuri titullin “Ditë kafenesh” dhe e botoi në revistën “Zëri i Rinisë”. Vepra u ndalua menjëherë nga autoritetet dhe i kritikuan rëndë ata që kishin lejuar botimin e saj.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Në fillim të vitit 1970 shtëpia botuese franceze Albin Michel botoi në frëngjisht romanin “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” përkthyer nga Jusuf Vrioni. Ai bëri bujë në Francë dhe u përkthye edhe në gjuhë të tjera. Në këtë kohë Kadare shkroi e botoi romanet “Kështjella” (1970) dhe “Kronikë në Gur” (1971), të cilat përkthehen e botohen në Francë njëra pas tjetrës.

Në vjeshtën e vitit 1990, i zhgënjyer nga përpjekjet e udhëheqjes komuniste për t’i zgjatur jetën regjimit, Ismail Kadare vendosi të arratiset nga Shqipëria në Paris dhe të kërkojë nëpërmjet mediave perëndimore vendosjen e demokracisë.

Me ndihmën e botuesit francez arrin të organizojë ikjen e familjes së tij. Ikja e tij u mirëprit nga ata që donin demokratizimin e Shqipërisë, kurse autoritetet e diktaturës komuniste e dënuan largimin e Ismail Kadaresë dhe e shpallën tradhtar.

Pas rënies së komunizmit në vitin 1992, ai u rikthye në Shqipëri. 8 Nga viti 1990 e më pas vepra e tij bëhet shprehja më e fuqishme e vlerave gjuhësore dhe artistike të shqipes letrare, brenda dhe jashtë vendit.

Letërsia e Ismail Kadaresë pas vitit 1990 bart të njëjtat tipare thelbësore të asaj të mëparshmes: frymën etnografike dhe shpërfaqjen e identitetit shqiptar. Duke shtuar lirinë e autorit për të trajtuar tema që më parë nuk mund të trajtoheshin lirshëm. Kadare ndan kohën mes Parisit dhe Tiranës.

Në vitin 1996 u pranua në Akademinë e shkencave sociale dhe politike në Francë, ku zëvendësoi filozofin Karl Popper. Nga viti 1994 deri 2004 shtëpia botuese franceze “Fayard” botoi veprën complete të Kadaresë në frëngjisht dhe shqip.

Në vitet e 90-ta Kadare lloboi për Kosovën dhe përkrahu bombardimet e NATO-s kundër Serbisë. Ismail Kadare është martuar me shkrimtaren e njohur të skicave dhe tregimeve për fëmijë, Helena Kadare, dhe ka dy vajza. Njëra prej tyre është përfaqësuese e Shqipërisë në OKB. Kadare flet shumë mirë gjuhën frenge.

Ismail Kadare përfaqëson shkrimtarin shqiptar më të njohur në letërsinë botërore, jo vetëm për titujt e shumtë të botuar e ribotuar ose dhe për gjuhët e shumta në të cilat është

***Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”***

***– analiza, krahasime dhe interpretime”***

përkthyer vepra e tij, por edhe për laureimet e nderimet që i janë bërë atij si shkrimtar në arenën ndërkombëtare.

Në vitin 1996, Ismail Kadare u bë anëtar për jetë i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Francë, e në të njëjtin vit, dekorohet nga institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë me urdhrin “Nderi i Kombit”, gjithashtu, është dekoruar edhe nga shteti francez me urdhrat “Kryqi i Legjionit të Nderit” dhe “Oficer i Legjionit të Nderit”, akorduar nga presidenti i Republikës Franceze (Zhak Shirak).

**Tituj e nderime** - Doktor Honoris Causa nga Universiteti “Stendal” i Grenoblit, në Francë (1992);

- në përvjetorin e tij të gjashtëdhjetë shpallet në Shqipëri Doktor Honoris Causa (1996);

- Doctor Honoris Causa nga Universiteti “Jean Monet” i Sant Etienne, në Francë (1997);

- dekorohet me medalje të artë në Athinë (1998);

- Qytetar Nderi i Tiranës (1999); - Qytetar Nderi i Gjirokastrës (2000); - merr titullin “Doktor Nderi” nga Universiteti i Prishtinës (2003);

- Doktor Honoris Causa nga Universiteti i Palermos (2009); - nderohet me “Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit”, dekoratë shtetërore e Kosovës etj.

**Çmime kombëtare** e ndërkombëtare Shkrimtari Ismail Kadare është laureuar me disa çmime letrare kombëtare e ndërkombëtare:

- çmimi “Të drejtat e reja të njeriut” në Holandë (1991);

- Koncert në fund të dimrit, libri më i mirë i vitit në Francë (1990);

- çmim letrar në Francë për romanin “Pallati i Ëndrrave” (1992);

- çmimi letrar “Kavur”, në Itali (1992);

Narratori dhe narracioni në prozën e Ismail Kadaresë

- çmimi letrar “Prix mondial Cino Del Duca”, në Francë (1992);

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

- çmim nderi për letrat shqipe (1997);
- çmimi letrar italian i përvitshëm “Bokaçio” për romanin Piramida (1997);
- çmimi gjerman “Herder” (1998);
- çmimi italian për letërsinë e huaj “Feronia” (1998);
- “Penda e artë”, në Shqipëri (2000);
- çmimi letrar britanik “Man Booker International Prize” (2005);
- çmimi letrar në Mitrovicë “Kepi i Shpresës së Mirë  
- Fahredin Gunga” (2006);
- çmimi për letërsinë në Festivalin e Dytë Internacional (2007);
- çmimi italian “Flaiano” (2009);
- çmimi “Ballkanika 2009” për romanin E penguara...;
- çmimi “Rexhai Surroi” në Kosovë, për romanin Darka e gabuar (2009);
- çmimi spanjoll “Prini i Asturias”, për artet (2009);
- çmimi italian “Lerici Pea” (2010);
- çmimi “La Risa de Bilbao” në festivalin Ndërkombëtar të Letërsisë dhe Artit  
Humoristik (2012);
- çmimi “Ali Podrimja” nga Universiteti “AAB”, në Prishtinë (2013); - çmimet  
“Angelus”, në finale me romanin Aksidenti (2014);
- çmimi “Jeronim de Rada” në Panairin e 17-të të Librit në Tiranë (2014), me  
motivacionin “Pasues i denjë i veprës emancipuese dhe evropianizuese të nisur nga De  
Rada, para 200 vjetësh” etj.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

**Çmime të rëndësishme ndërkombëtare** për letërsinë Shkrimtari Ismail Kadare është laureuar me shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai është nominuar disa herë për çmimin “Nobel”, madje ka qenë edhe shumë pranë rrëmbimit të këtij trofeu, por ende nuk e ka fituar këtë çmim.

Ndër çmimet më të rëndësishme letrare, të arenës ndërkombëtare, që është laureuar shkrimtari Ismail Kadare, do të përmendim: (1992) Prix mondial Cino Del Duca: çmim letrar në Francë që u jepet autorëve, veprat e të cilëve kanë shpërblyer si mesazh në kuadër të humanizmit modern.

Ky çmim është dhënë për herë të parë në vitin 1969 nga Simone Del Duca, për të vazhduar punën e të shoqit, botuesit Cino Del Duca. Ndër shkrimtarët që janë laureuar me këtë çmim do të përmendim: Jorge Luis Borges, Ernst Jünger, Yaşar Kemal, Jacques Ruffié, Thierry Maulnier, Eëilliam Styron, Jorge Amado, Robert Mallet, Václav Havel, François Nourissier, Simon Leys, Milan Kundera, Mario Vargas Llosa, Patrick Modiano, Andreï Makine etj. (1998) Herder Prize: çmim i themeluar në vitin 1963, emrin e mori për nder të Johann Gottfried von Herder.

Është çmim prestigjioz ndërkombëtar dedikuar shkencës, artit dhe letërsisë, i cili jepet për nder të shkencëtarëve ose të artistëve të Evropës Qendrore dhe Evropës Juglindore, jeta ose vepra e të cilëve ka ndikuar në kulturën, paqen dhe marrëdhëniet e ndërsjella mes popujve.

Ismail Kadare është laureuara me këtë çmim Narratori dhe narracioni në prozën e Ismail Kadesë në vitin 1998. Ndër shkrimtarë të tjerë që janë laureuar me çmimin “Herder” do të përmendim: Tudor Argherzi, Laszlo Nemeth, Zaharia Stancu, Jaan Kross, Imre Kertesz, Milan Kundera, Yuri Andrukhovych, Hanna Kall, Ene Mihkelson etj.

(2005) Man Booker International Prize: shkrimtari Ismail Kadare hapi siparin e këtij çmimi, ku mposhti edhe katër fitues të çmimit “Nobel”.

Ky çmim britanik, për letërsinë, jepet çdo dy vjet për veprat e shkruara ose të përkthyer në gjuhën angleze, për shkrimtarët që janë gjallë. Shkrimtarët më të rëndësishëm të nominuar ishin: Margaret Atëood, Gabriel García Márquez, Milan Kundera, Doris

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Lessing, Ian McEwan, Tomas Eloy Martinez, Philip Roth, Muriel Spark etj. Shkrimtarë që janë laureuar me këtë çmim, do të përmendnim: Philip Roth, Chinua Achebe, Alice Munro, Lydia Davis.

Në këtë çmim, duke qenë se anglishtja nuk ishte gjuha burimore e shkrimtarit Ismail Kadare, u shqua edhe kontributi i përkthyesit David Bellos, i cili e ka bërë të njohur veprën e Kadaresë në arealin anglofon.

(2009) Princ i Asturias:

Çmim prestigjioz i Spanjës për artet - një ndër çmimet letrare më prestigjioze në botë. Kadareja doli fitues mes tridhjetë e një kandidatëve, të cilët merrnin pjesë nga njëzet e pesë vende të ndryshme të botës, përmes të cilëve edhe Milan Kundera, Antonio Cabocchi etj.

Çmimi është themeluar më 24 shtator të vitit 1980 dhe jepet në kuadër të personaliteteve që kanë kontribuar në inkurajimin dhe promovimin e vlerave shkencore, kulturore dhe humaniste, që formojnë pjesë të trashëgimisë universale të njerëzimit.

Ndër shkrimtarët që janë laureuar me këtë çmim, do të përmendnim: José Hierro, Mario Vargas Llosa dhe Rafael Lapesa, Francisco Nieva, Claudio Rodríguez, Carlos Fuentes, Doris Lessing, Günter Grass, Arthur Miller, Paul Auster, Amos Oz, Margaret Atwood, Amin Maalouf, Leonard Cohen, Philip Roth, Antonio Muñoz Molina, John Banville etj.

(2010) Lerici Pea:

Ismail Kadare nderohet në Itali me çmimin Lerici Pea, çmim, i cili jepet që prej vitit 1954 dhe e kanë fituar shkrimtarë, si: Giovanni Titta Rosa, Massimo Grillandi, Rudi Pallabazzer, Carlo Betocchi, Ealter Bonta, Roberto Pazzi, Paolo Bertolani, Francesco Brusco, Fernando Bandini, Giovanni Giudici, Hans Magnus Enzensberger, Juan Gelman, Seamus Heaney etj.

Çmimi i jepet Kadaresë për rolin e poezisë dhe letërsisë si instrument liric, duke u bërë mbështetje për të gjithë njerëzit e botës, të cilëve iu mohohen liritë themelore.



*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Qëllimi i çmimit është promovimi i poezisë, në veçanti i poetëve të rinj, eksperimentimi i gjuhëve të reja poetike dhe njohja e poetëve të mëdhenj. (2012) La Risa de Bilbao: çmim që jepet në Festivalin Ndërkombëtar të Letërsisë dhe Artit Humoristik, edicioni i tretë.

Tema e këtij edicioni ishte humori si armë kundër barbarisë, në cilëndo formë që shfaqet. Ismail Kadare e ka fituar këtë çmim për sensin e humorit të zi dhe të ironisë që përdor në veprat e veta, përmes të cilave ka denoncuar barbarinë në Shqipëri.

(2015) Jerusalem Prize: është një çmim letrar kushtuar shkrimtarëve, veprat e të cilëve kanë trajtuar tema të lirisë së individit në shoqëri, jepet çdo dy vjet në Izrael, në kuadër të Panairit

Ndërkombëtar të Librit (në Jerusalem), që prej vitit 1963. Këtë çmim Narratori dhe narracioni në prozën e Ismail Kadaresë për herë të parë e fitoi britaniku Bertrand Russell, i cili kishte fituar Çmimin Nobel në vitin 1950.

Emra të tjerë të letërsisë botërore, që janë laureuar me këtë çmim, do të përmendnim: Max Frisch, André Schëarz-Bart, Ignazio Silone, Jorge Luis Borges, Octavio Paz, Graham Greene, Milan Kundera, Ernesto Sabato, Zbignieë Herbert, Mario Vargas Llosa, Arthur Miller, Leszek Kołakoëski, Haruki Murakami, Ian McEëan, Antonio Muñoz Molina etj., e së fundmi, në shkurt të vitit 2015, edhe Ismail Kadare.

## **7. PËRFUNDIM**

Me rastin e punimit të kësaj teme, erdhëm në përfundim se veprat e Kadaresë: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, janë një nga kulmet më të larta të prozatorisë shqiptare, evropiane dhe botërore.

Duke u mbështetur në veprimtarinë e bujshme të Kadaresë, e me theks të veçantë në këto dy romane, nxorëm në pah tezën romani si zhanër, zë një vend meritore në krijimet e këtij shkrimtari, arti i të cilit është burim i pashtershëm frymëzimi për studiues të ndryshëm.

Secila nga këto dy romane të Kadaresë ka rrezatimet e veta, të ndryshme prej të tjerave. Ato flasin për periudha kohore diktatoriale, që janë kthyer në arketipe letrare, filozofike, sociologjike, etj., për të komunikuar me shpirtat e lexuesve e të krijuesve të të gjitha kohëve dhe qytetërimeve.

Është interesant se forca mahnitëse e këtyre romaneve, ka tërhequr jo vetëm vëmendjen e publikut shqiptarë, por edhe kritikët letrarë, të cilët vazhdimisht janë munduar ta zbërthejnë domethënien shumëdimensionale të këtyre veprave letrare.

Si përfundim, nga ky punim kam nxjerr botën e pasur letrare të këtyre dy romaneve të Kadaresë, të cilat në vete ngërthejnë notat epik me një lirizmin të hollë të ndjenjave të brishta e të bukura të njeriut.

Është interesant se forca mahnitëse e prozës së shkrimtarit Ismaili Kadare, ka tërhequr jo vetëm kritikët letrarë vendorë, por edhe ata ndërkombëtarë: shkrimtarët, filozofë e sociologë, të cilët vazhdimisht janë munduar ta zbërthejnë elementet shumëdimensionale të këtij zhanri letrar.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

Mesazhi i romaneve të Kadaresë: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”, është i qartë dhe përçues nga të cilat kemi nxjerr si përfundim:

■ Në prozën e Ismail Kadaresë, figura e narratorit, si element i rëndësishëm ka funksione të larmishme. Ai, synon ta çlirojë rrëfimin nga normat klasike të tij, duke përdorur disa teknika narrative, të cilat janë të larmishme: dialogu, monologu, analogjia, aluzioni, alegoria etj.

■ Në sistemin letrar të Kadaresë, romani është, mbi të gjitha, rrëfimi i historisë së trilluar, edhe nëse ajo mund të marrë shkas prej një ngjarjeje të njëmendtë. Krijimtaria e Kadaresë i shmanget rrëfimit për ngjarjen, duke krijuar një ndryshim të raportit mes narracionit dhe përshkrimit, si “Pallati i Ëndrrave”, “Dimri i vetmisë së madhe”, “Kështjella” etj.

■ Aktin dhe procesin e të rrëfyerit e zotëron autori. Është ai që arrin të realizojë lojën narrative, sepse ai është krijuesi i veprës letrare. Është autori ai që thur ose ndërthur rrëfimin, të cilin mund ta vetërrëfejë ose të delegojë një personazh për ta rrëfyer.

■ Zhdërvjelltësia e ndërtimit të subjektit në romanet e Kadaresë, dallohet nga proza në prozë. Personazhet nuk janë të njëjtë, pra nuk janë të strukturuar, të kornizuar apo të përngjasuar. Tipare të tilla e bëjnë veprën e shkrimtarit Ismail Kadare një vepër të pasur nga këndvështrimi narrativ, por jo vetëm, vepra e tij është vepra e domethënies të shumta, vepër shumështrësore, e cila të ofron mundësi të pafundme interpretimi e analize.

■ Aspekti më i dukshëm në prozën e Kadaresë është mënyra e konceptimit dhe e ndërtimit të narracionit. Ai përmes trillimit artistik zgjedh që në historitë e rrëfyera, lexuesi të jetë i pozicionuar dhe të nxjerrë përfundimet e veta, pavarësisht atyre që i sugjerohen.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

- Në krijimtarinë e Kadaresë, midis tij dhe lexuesit ka një lidhje të veçantë e imediate, e cila sa komplekse e intuitive, aq edhe e nënkuptuar është.
- Elementi gjuhësor tek Kadareja përbën fushë të veçantë studimore, si në rrafshin gramatikor e leksikor ashtu edhe në rrafshin semantik. Idiolekti i këtij shkrimtari, nuk mbetet vetëm brenda kufijve të veprës së tij, por i shërben shqipes standarde, studiuesve, përkthyesve, madje edhe në veprat e shkrimtarëve të tjerë gjejnë vend shumë përdorime të fjalëve kadareane, shpeshherë të cilësuar si ‘gjuhë kadareane’ ose ‘stil kadarean’.
- Kadareja sjell risi, sidomos në mënyrën dhe organizimin e rrëfimit, në rolin e narratorit, në procedimet e ligjërimit, në pasurinë gjuhësore dhe për të gjitha elementet që ndërtohen zakonisht mbi gjuhën e simboleve.
- Shkrimtari Ismail Kadare i dha letërsisë shqipe pamje të re, në të gjithë përbërësit e vet, e sidomos në strukturimin e brendshëm narrativ. Ai theu skemat e strukturave të mendimit, si dhe format e ligjërimit artistik, duke i sjellë kështu prozës shqiptare një përmasë të re, përmasën universale.
- Roli i dialogut buron nga rrethanat, në të cilat veprojnë personazhet, nga zbulimet që narracioni bën vazhdimisht për ta. Dialogu bëhet pjesë vepruese e strukturës së narracionit, edhe pse duket sikur do të “prishë” rrëfimin.
- Ndërtimi dialog-rrëfim përcjell te lexuesi ankth, shqetësim, keqardhje, tension. Kjo ndodh sepse elementi narrativ e pranon dialogun si bashkëbisedim mes personazheve. Ndërthurja e dialogut me rrëfimin sjell njëfarë ndryshimi në strukturën narrative të romanit. Kadareja gjatë rrëfimit të një ngjarjeje e fton zërin e jashtëm (zërin iracional të personazheve), që të shpalosë idetë e tij. Ky lloj dialogu lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ligjërimin e autorit.

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

■ Romani “Pallati i Ëndrrave” përfaqëson intuitën krijuese, universin imagjinar ndoshta më të larmishëm në krijimtarinë e shkrimtarit Ismail Kadare. Këto krijime autentike, e përfytyrime njëkohësisht, nuk përfaqësojnë vetëm krijime të kategorive leksikore, por edhe krijime të kategorive konceptuale (ideore, kuptimore), duke filluar që nga institucioni i Tabir Sarajit “Pallatit të Ëndrrave”, ëndërrparësve, ëndërrçuesve, bashëndërrës/kryeëndërrës Narratori dhe narracioni në prozën e Ismail Kadaresë etj., e duke vazhduar tek endja e ëndrrave dhe sistemi simbolik që i shoqëron e i zbërthen ato.

■ Pallati i Ëndrrave është pjesë e një universi imagjinar kadarean, si pjesë e fiction-it dhe, gjithashtu, shembulli i kontrollit që ndodh në një shoqëri distopike, nën tryshninë e një qeverie totalitare, të drejtuar nga diktatura e sistemit komunist.

Krijimtaria e shkrimtarit Ismail Kadare është shkruar gjysma në komunizëm e gjysma tjetër pas rënies së tij, por vepra e tij nuk mund të periodizohet politikisht, e kjo është meritë e padiskutueshme e këtij shkrimtari.

Vepra e tij nuk i ndien ndryshimet politike që ka pësuar vendi ynë, shembulli më tipik është romani Piramida, i shkruar gjysma në Shqipërinë komuniste, në Tiranë, ndërsa gjysma tjetër pas rënies së komunizmit, në kapitalizëm (në Perëndim), në Paris.

Koherenca e romanit bën që të mos dallohet se është shkruar në dy vende dhe në dy regjime krejt të ndryshme.

Vepra e shkrimtarit Ismail Kadare dallohet për një gjuhë artistike të nivelit të lartë, duke treguar interes të veçantë në livrimin e shqipes së kulluar dhe duke e pasuruar atë, si në rrafshin leksikor ashtu edhe në rrafshin gramatikor.

## **8. LITERATURA**

- KADARE, Ismail, (2009), Pallati i ëndrrave, Tiranë, Onufri;
- KADARE, Ismail, (1973), Dimri i vetmisë së madhe, Tiranë, Naim Frashëri;
- KADARE, Ismail. (1981), Vepra (vëllimi 8). Tiranë, Naim Frashëri Dimri i madh;
- NDRECA, Ardian (2016), Kadare, leximi dhe interpretimi, Onufri, Tiranë;
- MIFTARAJ, Kastriot (2006), Kodi sekret i romanit Pallati i ëndrrave, Buzuku, Prishtinë;
- ÇAUSHI, Tefik; Shkurtaj Gjovalin, (2004), Kadare dhe fjala shqipe, Tiranë, Tetovë, Prishtinë, Albas;
- ALIU, Gëzim, (2007), Diskurset e ideve në prozën e Kadaresë, Prishtinë, Faik Konica;
- BEJA, Fatos, (1988), Veçori të rrëfimit artistik në romanin “Dimri i madh” të Ismail Kadaresë. “Studime filologjike”. Tiranë;
- ÇAUSHI, Tefik, (2001), Universi letrar i Kadaresë, Tiranë, Dajti;
- DERVISHI, Met, (2014), Intertekstualja dhe disidentja te “Dimri i vetmisë së madhe”. Tiranë, Saras;
- KULLA, Ndriçim, (2013), Ylli i shkrimtarit: biografi e Ismail Kadaresë, nga koha e tiranisë deri më sot, Tiranë, Plejad;
- DASHI, Brunilda, (2010), Romanzo “Dimri i vetmisë së madhe” di Ismail Kadare: storia del testo e Il studio delle varianti. Roma, Centro di Studi Albanesi;
- ÇAUSHI, Tefik, (1995), Kadare, fjalor i personazheve, Tiranë, Shtëpia Botuese Enciklopedike;
- DADO, Floresha, (1988), Krijimi i figurave në Koncert në fund të dimrit, “Drita”. Tiranë;
- ISUFAJ, Viola, (2013), Rikthimi i mitit në veprën e Ismail Kadaresë, Tiranë, Onufri;
- KOËÇIÇI, Adedin, (2004), Gjuha e veprave në prozën e Ismail Kadaresë nga aspekti i fjalëformimit, Tiranë, Dita;

*Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”*

*– analiza, krahasime dhe interpretime”*

NDRECA, Ardian, (2016), Kadare, leximi dhe interpretimi, ese dhe studime në tetëdhjetë vjetorin e lindjes, Onufri 2016;

FRAJ, Northop, (1990), Anatomia e kritikës, Prishtinë, Rilindja; ÇAUSHI, Tefik, (1995), Kadare, fjalor i personazheve, Tiranë, Shtëpia Botuese Enciklopedike;

DADO, Floresha, (1997), Proza nëpër teknikat narrative, Tiranë, Toena;

KOSTA, Alfred, (2010). Koha e Kadaresë. Tiranë, Dituria KRASNIQI, Bajram. Raporti i rrëfimit në prozën e Kadaresë. “Fjala”, Prishtinë;

DADO, Floresha, (1997), Proza nëpër teknikat poetike. Tiranë, Toena;

DADO, Floresha, (2003), Teori e veprës letrare – Poetika, Tiranë;

ÇAUSHI, Tefik, (2001), Universi letrar i Kadaresë. Tiranë, Dajti;

ÇAUSHI, Tefik; Shkurtaç Gjovalin. (2004), Kadare dhe fjala shqipe, Tiranë, Tetovë, Prishtinë, Albas’

ÇAUSHI, Tefik. (1995). Kadare, fjalor i personazheve. Tiranë, Shtëpia Botuese Enciklopedike

BEJA, Fatos, (1988), Veçori të rrëfimit artistik në romanin “Dimri i madh” të Ismail Kadaresë. “Studime filologjike”. Tiranë;

KADARE, Ismail. (1981). Vepra (vëllimi 8). Tiranë, Naim Frashëri Dimri i madh [1971-1976]

ZOTO, Aleksandër,(1990) Historia dhe letërsia në krijimtarinë e Ismail Kadaresë, Studime Filologjike, nr. 1, Tiranë;

SHABANI, Sinan, (2005), Një dosje për Kadarenë, Tiranë, 2005;

***Kadareja dhe veprat: “Pallati i ëndrrave” dhe “Dimri i vetmisë së madhe”  
– analiza, krahasime dhe interpretime”***